

2025


RAPORTI VJETOR



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

2025
RAPORTI VJETOR

TIRANË, MARS 2026



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Përmbajtja

HYRJE.....	7
1. MESAZHI.....	9
2. KUADRI LIGJOR.....	15
3. RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE.....	25
4. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT NË VITIN 2024.	27
5. OBJEKTIVA DHE INDIKATORË TË SYNUAR PËR 2025.....	33
6. VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE.....	35
6.1 ARKIVI.....	35
6.2 INFORMIMI I INDIVIDËVE DHE QYTETARËVE.....	39
6.3 VERIFIKIMI I FIGURAVE	45
6.4 MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË DIKTATURËS.....	48
6.5 MBËSHTETJASHKENCOREDHEEDUKIMI QYTETAR.....	54
6.6 SIGURIA DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK.....	60
6.7 SHËRBIMETEBRENDSHMEDHEFINANCA.....	66

HYRJE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (/AIDSSH) është institucion i pavarur, organ kolegjal i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë nga të cilët: 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kuvendi i Shqipërisë, 1 (një) anëtar i propozuar nga Këshilli i Ministrave, 1 (një) anëtar përfaqësues i propozuar nga shoqatat e të përndjekurve politikë dhe 1 (një) anëtar i propozuar nga Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Në muajin qershor 2022, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi me shumicë votash bordin e ri drejtues të Autoritetit. Kjo procedurë u ndërmor për shkak të përfundimit të mandatit të Bordit të parë. Në bordin e ri u zgjodh Kryetarja në detyrë e këtij institucioni, znj. Gentiana Sula, anëtari aktual i bordit z. Altin Hoxha, z. Albert Nikolla si propozim i Kryeministrit, z. Gjergj Marku u votua mes 3 kandidatëve nga shoqatat e ish-të përndjekurve politikë dhe z. Skënder Vrioni u votua si e vetmja kandidaturë nga organizatat e të drejtave të njeriut. Në muajin dhjetor 2022, Kuvendi i Shqipërisë rizgjodhi në krye të AIDSSH znj. Gentiana Sula. Në këtë mandat të dytë, në vitin 2024 AIDSSH ka në përbërjen e tij, anëtarët si më poshtë vijon:

Znj. Gentiana Sula – kryetare

Z. Albert Nikolla – anëtar

Z. Altin Hoxha – anëtar

Z. Gjergji Marku – anëtar

Z. Skënder Vrioni – anëtar

AIDSSH është përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe për sigurimin e aksesit në to, për të gjitha subjektet e ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar, në funksion të edukimit të publikut dhe mbështetjes së vlerave demokratike të drejtësisë, të së vërtetës, të pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

Raporti vjetor i punës për vitin 2025 është hartuar në përputhje me objektin dhe qëllimin e ligjit organik nr. 45/2015, *“Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, i ndryshuar, aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, që normojnë dhe rregullojnë veprimtarinë funksionale të institucionit, si dhe në Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik të Kuvendit.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti ka zhvilluar 54 mbledhje dhe ka marrë 666 vendime, nga të cilat 664 vendime unanime, një vendim me një votë kundër dhe një vendim me dy vota pjesërisht kundër; janë nënshkruar shtatë marrëveshje bashkëpunimi dhe janë negociuar nëntë të tjera, çfarë tregon një punë voluminoze të Sekretariatit Teknik, me përgjegjësi maksimale kundrejt misionit të institucionit nëpërmjet mbledhjeve të rregullta të AIDSSH-s, me impakt në fushën e demokratizimit të shoqërisë, për të mundësuar ushtrimin e së drejtës të të interesuarve për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

MESAZHI

1. MESAZHI

Shoqëritë që kanë kaluar përvoja diktatoriale, si Shqipëria, përballen me një sfidë të dyfishtë: ndërtimin e institucioneve demokratike dhe me të kaluarën. Në këtë proces, e vërteta historike nuk është thjesht çështje akademike, por themeli i besimit publik dhe i rendit demokratik. Viti 2025 shënon një fazë më të pjekur të këtij procesi, duke e zhvendosur rolin e AIDSSH nga administrimi i dokumenteve drejt një modeli aktiv, të matshëm në ndikim publik, kërkesë dhe rezultate konkrete.

Kjo reflektohet qartë në tregues. Gjatë vitit janë trajtuar 936 kërkesa gjithsej nga qytetarë, studiues dhe institucione, të cilëve janë shërbyer **250,442 fletë dokumente arkivore**. Duke treguar se është ruajtur një ritëm të lartë funksional në drejtim të informimit edhe është ganatuar akses i vazhdueshëm për publikun.

Mbështetja shkencore dhe edukimi qytetar kanë shënuar arritje të spikatura gjatë vitit 2025; nga njëra anë duke rritur aksesin në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe hulumtimit të tyre dhe nga ana tjetër duke shtuar komunikimin me nxënësit, mësues, studentë dhe pedagogë në njohjen e pltoë dhe rishkrimin e narrativës për periudhën 1944-1991

Në planin shkencor, u konsolidua baza për kërkim përmes hartimit të një Udhëzuesi të posaçëm për studiuesit dhe median, në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë dhe me mbështetjen e

Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Së bashku me ndryshimet ligjore të fundvitit 2022, kjo ndikoi në rritjen e ndjeshme të aksesit, duke kulmuar me mbi 1300 dosje të vëna në dispozicion në vitin 2023. Në vijim, kërkesat studimore arritën në 156 në vitin 2025, ndërsa volumi i dokumenteve u rrit nga 29,556 në mbi 135 mijë faqe.

Në këtë kuadër, u zhvillua Simpoziumi “Nga e kaluara në përkujtim – Kufijtë e diktaturës 1944–1991”, i cili hulumtoi ngjarjet në kufi në zonat juglindore dhe verilindore të vendit, përgjatë kufijve me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, projekt i cili këtë vit vijoi me “Kufiri i shpresës dhe i vdekjes 1944–1991”, duke zgjeruar kërkimin edhe në zona të tjera kufitare si liqeni i Shkodrës dhe Hani i Hotit.

Po kështu u prodhua dokumentari “Ana tjetër e Valiasit”, i cili shënon një qasje të re, duke e kthyer dokumentin arkivor në rrëfim të kuptueshëm dhe të prekshëm për publikun.

Arkivi i dëshmimeve është pasuruar këtë vit me 36 dëshmi të reja, duke çuar në total 165 dëshmi gojore burime të dorës së parë që përbëjnë një bazë të çmuar për dokumentimin historik. të cilat ndihmuan kryesisht në ndërtimin e të dhënave për kampin e vuajtjes së Valiasit, pasuruan simpoziumin për kalimet e paligjshme në Shkodër dhe platformën Spac.al.

Kjo linjë e qëndrueshme e studimit mbi kufirin do të vijojë në vitin 2026, duke sjellë hulumtime të reja shkencore dhe dëshmi mbi kalimet në kufi Shqipëri-Kosovë, duke shënuar kështu dy partnerë të rinj të AIDSSH në fushën e studimit: Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe Institutin e Historisë “Ali Hadri”.

Ndërsa turi i leximit dhe informimit që u mbajt në 11 shkolla të vendit me mbështetjen e Këshillit të Evropës, siguroi të parin komunikim masiv dhe intensiv me mësues dhe nxënës. Botimet e posaçme të AIDSSH për arsimin parauniversitar dhe një dokumentar, së bashku me ish – të dënuar politikë informuan të rinjtë jo vetëm për ngjarje si Revolta e Spaçit apo arratisjet në kohën e diktaturës, por mësuan sidomos për shkeljen e të drejtave të njeriut në diktaturë.

Në fushën e edukimit qytetar, gjatë vitit 2025, për herë të parë, në bashkëpunim me ASCAP dhe ISKK, u hartuan modele mësimore të bazuara në dokumente arkivore dhe dëshmi gojore për integrimin e historisë së komunizmit në arsimin parauniversitar, sipas marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit (2021).

Në vijim të përmbushjes së nismave të marra për ndërtimin e platformës digjitale “Mësojmë nga e kaluara - me burime të hapura arsimore 1944-1991” ka vijuar zhvillimi i klubeve të librit dhe filmit, të cilët kanë në fokus kryqëzimin e perspektivave të ndryshme mbi librat dhe filmat e marrë në analizë për të thelluar kuptimin e të vërtetave të personazheve dhe ngjarjeve që trajtohen në to, duke u bazuar tek dokumenti arkivor dhe tek dëshmia e gjallë.

Mbi 36 aktivitete publike, me mbi 1,000 pjesëmarrës dhe ndikim te rreth 2,500 nxënës, dëshmojnë se arkivi është kthyer në një instrument konkret edukimi dhe ndërgjegjësimi qytetar.

Gjatë vitit u miratuan dhe nënshkruan **6 marrëveshje bashkëpunimi** midis AIDSSH dhe institucioneve partnere: Arkivi Qendror Shtetëror i

Filmit (AQSHF), Universiteti i Shkodrës “Luigi Gurakuqi”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, fondacioni “kujto.al” dhe fondacioni “Konrad Adenauer”. Projektet dhe nismat vijojnë të marrin mbështetje nga partneriteti i AIDSSH- partnerë ndërkombëtarë, përfshirë BE, OSBE, ICMP dhe Këshillin e Evropës, duke i dhënë kërkimit dhe edukimit një dimension të gjerë dhe të standardizuar sipas praktikave ndërkombëtare.

Në dimensionin e komunikimit dhe aksesit në dokumente arkivore janë zhvilluar platformat digjitale si Spac.al, ndërsa ka filluar edhe puna për faqen e dedikuar për kampin e Tepelenës. Gjatë vitit 2025 platforma Mediateka ka hyrë në fazën e popullimit me materiale të anonimizuara dhe të indeksuara sipas standardeve të metadatave.

Procesi i kërkimit për personat e zhdukur ka hyrë në një fazë më të avancuar, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të kërkesave nga familjarët. Gjatë vitit 2025 janë administruar 69 kërkesa, duke e çuar në 410 numrin total deri më sot.

Në vijim të këtij angazhimi, gjatë viteve 2023–2024 janë miratuar 6 vendime për nisjen e verifikimeve administrative, nga të cilat janë identifikuar 11 vendvarrime të dyshuara. Në 6 prej tyre, në bashkëpunim me ICMP, u zhvilluan për herë të parë aktivitete kërkimore me metoda shkencore jo-invasive, të cilat kanë dhënë rezultate konkrete dhe kanë rekomanduar kalimin në fazën e ndërhyrjeve gërmuese për evidentimin dhe identifikimin e eshtrave të personave të zhdukur.

Gjatë vitit 2025 janë iniciuar gjithashtu 4 vendime të reja për verifikime administrative, që lidhen me 5 raste/vendvarrime të dyshuara, duke vijuar zgjerimin dhe thellimin e procesit hetimor. Paralelisht, në bashkëpunim me pushtetin vendor, janë vendosur 4 tabela shenjuese me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre vendeve. Në këtë kuadër, AIDSSH hartoi manualin për modalitetet e bashkëpunimit me strukturat vendore, në funksion të trajtimit të vendvarrimeve të dyshuara.

Në kuadër të memorializimit dhe ruajtjes së kujtesës historike, janë konsultuar dhe shqyrtuar propozimet për dy projekte memoriale: memoriali “Shtegu i Lirisë” në Ersekë dhe projekti i memorialit “Muri i Gjakut” në Shkodër, si iniciativa që synojnë nderimin e viktimave dhe forcimin e ndërgjegjësimit publik mbi të kaluarën.

Me mbështetjen e ICMP, Shqipëria bëhet për herë të parë pjesë e sistemit ndërkombëtar të menaxhimit të të dhënave për personat e zhdukur gjatë regjimit komunist, duke integruar informacionin në sistemin iDMS, një platformë e standardizuar dhe e përdorur ndërkombëtarisht për trajtimin e rasteve të zhdukjeve.

Procesi i rikuperimit të eshtrave vazhdon të hasë pengesa, kryesisht për shkak të mungesës së një kuadri të plotë dhe të qartë ligjor, si dhe të vonesave në miratimin e akteve nënligjore përkatëse, përfshirë vendimin e Këshillit të Ministrave. Këto boshllëqe krijojnë paqartësi në ndarjen e përgjegjësisive institucionale dhe në procedurat që duhet të ndiqen, duke ngadalësuar ritmin e një procesi që kërkon koordinim të lartë dhe vendimmarrje të shpejtë.

Si pasojë, kjo ndikon drejtpërdrejt në përmbushjen e plotë të një detyrimi të rëndësishëm të shtetit shqiptar: gjetjen, identifikimin dhe kthimin e eshtrave të personave të zhdukur pranë familjarëve të tyre, si një e drejtë themelore e njeriut dhe një domosdoshmëri për rivendosjen e dinjitetit, drejtësisë dhe besimit publik

Gjatë vitit 2025, Autoriteti vijoi përmbushjen e detyrimeve ligjore për verifikimin e figurës së kandidatëve për poste publike, si dhe për propozime për tituj nderi, dekorime dhe emërtime të hapësirave publike, duke garantuar transparencë dhe saktësi përmes analizës së thelluar të dokumenteve arkivore. Në periudhën janar–dhjetor 2025 u verifikuan 242 kandidatë, nga të cilët 15 rezultuan me gjetje në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Krahasuar me vitin 2024, vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të kërkesave, nga 128 nga 82, ndërsa numri i kandidatëve të verifikuar mbetet në nivele të përafërta .

Një peshë të rëndësishme në këtë proces zë pushteti vendor: 42 kërkesa, ose 30% e totalit, vijnë nga 22 bashki, duke shënuar rritje krahasuar me vitin paraardhës. Nga vendimet e marra, 53 i përkasin kërkesave të bashkive, ndërsa 12 nga 15 gjetjet lidhen me kandidatë të propozuar prej tyre për tituj nderi, dekorime apo emërtime hapësirash publike. Në tërësi, 115 nga 242 kandidatët e verifikuar (48%) ishin të propozuar pikërisht për këto forma vlerësimi publik.

Për të lehtësuar dhe standardizuar këtë proces, Autoriteti hartoi dhe shpërndau Udhëzuesin për Pushtetin Vendor, i cili përcakton qartë hapat, do-

kumentacionin dhe mënyrën e komunikimit institucional gjatë verifikimit të figurës. Ky instrument ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e bashkëpunimit me bashkitë, ka rritur numrin e kërkesave të sakta dhe ka ndihmuar në zbatimin korrekt të kërkesave ligjore.

Bashkëpunimi me subjektet politike mbetet një sfidë e hapur. Pavarësisht njoftimit zyrtar drejtuar 53 subjekteve politike, vetëm 6 kandidatë paraqitën kërkesë për verifikim me iniciativë personale. Kjo mungesë angazhimi vijon të ndikojë në zbatimin e nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 dhe cenon standardet e transparencës në proceset zgjedhore.

Arkivi ka vijuar me **digjitalizimin e 16,229 imazheve dhe 2,715 dublikatave fotokopje** nga dosje personale, regjistra dhe kartela. Janë deklasifikuar **390,690 fletë dokumente**, Ndër arritjet më të rëndësishme strukturore të vitit mbetet puna për **kartotekën dhe mjetet e kërkimit arkivor**, të cilat përbëjnë bazën e ndërtimit të një sistemi modern informacioni. Gjatë vitit është vijuar përpunimi i kartelave duke krijuar **1,373,911 fusha të reja të dhënash**.

Gjatë vitit 2025, procesi i deklasifikimit është përballur me vonesa për shkak të ndryshimeve në kuadrin ligjor, ku ndonëse ndryshimet në ligjet nr. 45/2015 dhe nr. 10/2023 kanë synuar thjeshtimin e këtij procesi, VKM-ja nr. 822/2024, e miratuar pa konsultimin me AIDSSH, ka sjellë ndërlikime procedurale dhe vonesa. Për këtë fakt, AIDSSH ka shprehur shqetësim dhe ka ndërmarrë hapa për rishikimin dhe miratimin e akteve të brendshme që rregullojnë procesin e deklasifikimit, e ndër të tjera

i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave për harmonizimin e ligjeve 45/2015 dhe 10/2023 si dhe rishikimin e VKM-së, me qëllim vijimin e deklasifikimit në AIDSSH sipas një praktike të ngjashme me atë të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.

Në këtë kontekst, përballja me të kaluarën nuk është më vetëm një proces i kujtesës, por një detyrim i vazhdueshëm institucional dhe shoqëror. Ajo kërkon vendimmarrje të qartë, bashkëpunim të qëndrueshëm ndërinstucional dhe një angazhim të përbashkët për të garantuar që e vërteta të mos mbetet e fragmentuar apo e vonuar. Vetëm përmes këtij bashkëpunimi mund të sigurohet që çdo dokument të flasë, çdo histori të zbardhet dhe çdo familje të marrë përgjigjen që i takon.

Sepse në fund, përballja me të kaluarën nuk është thjesht një detyrë e institucioneve, por një përgjegjësi ndaj dinjitetit njerëzor. Çdo dokument i hapur, çdo dëshmi e mbledhur dhe çdo eshtër e rikthyer është një hap drejt drejtësisë dhe një akt besimi ndaj së ardhmes.

The background is a solid light orange color. In the center, there are two large, semi-transparent numbers: a '0' on the left and a '2' on the right. Overlaid on these numbers is the text 'KUADRI LIGJOR' in a white, bold, sans-serif font. The background also features faint, grey cursive script that appears to be bleed-through from the reverse side of the page.

KUADRI LIGJOR

2. KUADRI LIGJOR

Gjatë vitit 2025, legjislacioni mbi të cilin mbështetet dhe organizohet puna e AIDSSH, nuk ka pësuar ndryshime.

AIDSSH organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara nga **baza ligjore e mëposhtme:**

Ligj nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, i ndryshuar; ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*; ligji nr. 115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar; ligji nr. 12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Shërbimet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”* i ndryshuar; ligji nr. 7514, datë 30.9.1991 *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*; ligji nr. 152, datë 30.05.2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar; ligji nr. 124/2024, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar; ligji nr. nr. 10/2023 *“Për informacionin e klasifikuar”*; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, *“Për arkivat”*, i ndryshuar; Ligj nr. 119, datë 14.09.2014, *“Për të drejtën e Informimit”*; ligj nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë”*;

në akte nënligjore si vijon: vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 95, datë 22.12.2016 *“Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozi-*

cioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”; vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 15.02.2017 *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish - Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete të tjera publike”*; vendim i Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 28.12.2016 *“Për kalimin nën përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit, të objektit nr. 52, me emërtim “Arkivi i Ri”, brenda territorit të pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjja nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, me anë të së cilës është përcaktuar mjedisi në të cilin AIDSSH do të ushtrojë veprimtarinë e vet; vendimi nr. 93, datë 27.02.2020, i Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*;*

Akte rregullatore të brendshme të AIDSSH: Rregullore e brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH-së”*, miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.02.2024 të Autoritetit (version i rishikuar); Rregullore *“Për parandalimin e konfliktit të intere-*

save në ushtrimin e funksioneve publike në AIDSSH”, miratuar me vendimin nr. 13, datë 14.04.2017; rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në AIDSSH”, miratuar me vendimin nr. 25, datë 25.05.2017, të Autoritetit; rregullore “Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, përmes buletinit në letër apo online në faqen e Autoritetit”; vendimi nr. 97, dt. 12.02.2024, “Për miratimin e propozimeve ligjore “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 538, datë 07.10.2020 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ‘Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit’”; vendimi nr. 177, datë 04.04.2024, “Për miratimin e udhëzuesit ‘Për rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person dhe fomularit të aplikimit’.

Gjatë vitit 2025, legjislacioni mbi të cilin mbështetet dhe organizohet puna e Autoritetit/AIDSSH, nuk ka pësuar ndryshime, veç përmirësimeve në akte rregullatore të brendshme të Autoritetit e konkretisht udhëzuesve:

- “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim Nr.413, datë 18.09.2025;

- “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendim Nr. 409, datë 18.9.2025;

- “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave të palëve të prekura, të treta, bashkëpunëtorëve dhe të favorizuarve”, miratuar me vendim Nr. 408, datë 18.9.2025;

- “Mbi Procedurat për trajtimin e kërkesave nga institucionet kushtetuese, autoritetet publike dhe subjektet e tjera”, miratuar me vendim nr. 418 datë 02.10.2025.

Po kështu, me ndryshimet që pësoi legjislacioni në fund të vitit 2024, u rishikuan **Akte rregullatore të brendshme:**

1. Marrëveshje bashkëpunimi midis SHISH dhe AIDSSH “Për vlerësimin paraprak lidhur me cenimin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve dhe sigurinë kombëtare, gjatë procesit të deklasifikimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit”.
2. Urdhër nr. 273, datë 10.11.2025 “Për ngritjen e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’ të dokumenteve të ish-sigurimit të shtetit (neni 44/4, ligji 45/2015, i ndryshuar)”.
3. Urdhër nr. 238, datë 08.10.2025 “Për ngritjen e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të prodhuara nga AIDSSH dhe institucione të tjera ekzistuese (viti 2017 e në vijim)”.

Nevoja për ndryshime në legjislacionin aktual

a. Problematika lidhur me procesin e deklasifikimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në AIDSSH

Gjatë vitit 2025, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) është përballur me një problematikë të rëndësishme që lidhet ngushtë me procesin e deklasifikimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Që nga viti 2017, AIDSSH ka realizuar deklasifikim masiv të këtyre dokumenteve, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 45/2015, si dhe nga rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë ndër vite. Në vitin 2022, ky ligj pësoi disa ndryshime lidhur me procesin e deklasifikimit. Po ashtu, në vitin 2023 u ndryshua edhe ligji “Për informacionin e klasifikuar”, me synim lehtësimin e këtij procesi.

Në këtë kuadër neni 44, pika 4 dhe 5 e tij citon se: «**4. Të deklasifikohen të gjitha dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të parashikuara në këtë ligj për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë. 5. Autoriteti përgjegjës për grumbullimin dhe administrimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, kur gjatë punës ndeshet me dokumente që përmbajnë informacione që lidhen me cenimin e sigurisë kombëtare, i klasifikon**

ato sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar”, si dhe nenin 22/4 të ligjit nr. 10/2023 ku citohet se: “Përjashtimisht, konsiderohen të deklasifikuara dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë. Nga zbatimi i kësaj dispozite, përjashtohen dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe sigurinë kombëtare.”.

Ndërkohe që ne dhjetor të vitit 2024 hyri në fuqi VKM-ja nr. 822/2024, për miratimin e të ciles nuk është kërkuar konsultimi me AIDSSH. Kjo VKM ka sjellë ndërlkime në procesin e deklasifikimit, pasi në nenin 48, gerat b) dhe c), citon se: b) Kur ministria/institucioni prodhues i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” nuk ekziston, **ftohet të marrë pjesë në mbledhje një përfaqësues i ministrisë/institucionit që ka në fushën e përgjegjësisë veprimtarinë e institucionit të origjinës.** c) Kur nuk ekziston ministria/institucioni prodhues i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe veprimtaria apo dokumentacioni i tij nuk i kanë kaluar asnjë institucioni tjetër shtetëror, **ftohet të marrë pjesë një përfaqësues i një institucioni, fusha e veprimtarisë e të cilit është e ngjashme me fushën e veprimtarisë së fondkrijuesit.”**

Në këto kushte, dhe në zbatim të VKM-së nr. 822/2024, AIDSSH ka shprehur shqetësimin e saj dhe ka ndërmarrë hapa për rishikimin dhe mi-

ratimin e akteve të brendshme që rregullojnë procesin e deklasifikimit. Si pasojë, procesi është ngadalësuar, pasi kërkohet marrja e opinionit nga SHISH për çdo rast deklasifikimi, gjë që kërkon kohë të konsiderueshme për shqyrtimin dhe vlerësimin përfundimtar të çdo dokumenti, edhe pse jo çdo dokument përbën rrezik për sigurinë kombëtare apo marrëdhëniet ndërmjet shteteve.

Duke qenë se kjo situatë ka sjellë vonesa në vijimin e procesit të deklasifikimit masiv, si dhe duke pasur parasysh detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 45/2015 dhe rezolutat e Kuvendit, AIDSSH ka ndërmarrë hapa konkretë për zgjidhjen e kësaj problematike duke dërguar kërkesë për bashkëpunim drejtuar Kuvendit në datë 19.11.2025 për harmonizimin e ligjeve 45/2015 dhe 10/2023 si dhe Këshillit të Ministrave në datë 10.02.2026 për të ofruar mbështetje për rishikimin e VKM-së nr. 822, datë 26.12.2024, ku në zbatim të ligjit, AIDSSH të vijojë me deklasifikimin sikurse vepron DPA dhe SHISH të thirret vetëm në rastet kur KDZH vlerëson se dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit mund të përbejnë premisa për cenim të sigurisë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërmjet shteteve.

b. Problematika të hasura në legjislacionin për Arkivat

- Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për Arkivat”, nga 1 Janari 2025, arkivi i sistemit të Ministrisë së Brendshme ka kaluar në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, duke bërë që fondet

arkivore të mos administrohen më nga Ministria e Brendshme. Kjo situatë, e konfirmuar edhe me shkresën nr. 136, datë 24.01.2025, sjell rënien nga fuqia të akteve të përbashkëta të mëparshme dhe ndryshon mënyrën e bashkëpunimit ndërinstitucional në administrimin e këtyre fondeve.

Për rrjedhojë, përgjatë vitit 2026 vijon e njëjta pengesë institucionale në raport me aksesin dhe shfrytëzimin e fondeve arkivore të Ministrisë së Brendshme, pasi ato nuk janë transferuar ende nga Ministria e Brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave (DPA).

Këto rrethana pengojnë AIDSSH-n në ushtrimin e plotë të detyrave funksionale, duke çuar në vendimmarrje jo të plota dhe jo shteruese për shkak të mungesës së fondeve arkivore të kërkuara, si dhe duke cenuar besueshmërinë e publikut në veprimtarinë e Institucionit.

Në përmbushje të funksionit dhe qëllimit të ligjit 45/2015, i ndryshuar, shprehim gatishmërinë dhe bashkëpunimin për ndërmarrjen e të gjitha procedurave të mëtejshme për zbatimin e plotë të VKM-së nr. 98/2017 apo akteve të tjera që kanë mbetur pa u zbatuar nga disa nga institucionet që administrojnë dokumentet që i përkasin dhe janë pjesë e fushës së veprimit të ligjit 45/2025 i ndryshuar. Kërkohet ndërhyrja dhe mbështetja juaj (Kuvendit/Këshillit të Ministrave) me qëllimin e grumbullimit dhe kalimit nën administrim të fondeve dhe materialeve arkivore që disponohen dhe administrohen nga institucionet e tjera, sipas rekomandimit pika 5 e Rezolutës së Kuvendit.

c. **Problematika të hasura veçanërisht me ligjin 9831/2007 dhe aktet nënligjore të cilat afektajnë njohjen, verifikimin dhe dëmshpërblimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha kategorive të ish të përndjekurve politikë, përfshirë personat e internuar pa dokumentacion zyrtar, të lindurit apo të miturit në internim, familjarët e viktimave të ekzekutuara, si dhe ata që kanë kryer punë të detyruar gjatë vuajtjes së dënimit.”**

- ***Mungesë të akteve administrative apo dokumenteve zyrtare që provojnë internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba, jo për faj të personave të internuar.*** Në këtë kuadër, do të sugjerohet rishikimin e ligjit nr. 9831/2007 me qëllim adresimin e problematikës së lartpërmendur dhe mundësimin e përfitimit, qoftë edhe të një shume simbolike, për këdo që ka vuajtur në kampe internimi me tela me gjemba, për të cilin është e mundur nxjerrja e informacionit nga burimet arkivore të disponuara; adresimin përmes akteve nënligjore ekzistuese apo atyre që do të hartohen në zbatim të ligjit nr. 9831/2007, si dhe harmonizimin e nevojshëm me ligjin nr. 7514, datë 30.09.1991 *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar*, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- ***Pengesa për njohjen dhe dëmshpërblimin e personave që kanë lindur në internim apo kanë qenë nën moshën 15 vjeç në kushte internimi:*** aktet administrative apo dokumentet zyrtare të kërkuara nga kuadri ligjor në fuqi

kanë qenë për prindërit. Për të lindurit dhe të miturit në internim, nuk ka akte individuale të kësaj natyre. Për më tepër, Udhëzimi nr. 2, datë 4.1.1992, në pikën 10 parashikon se koha e internimit dhe e dëbimit për motive politike, nuk njihet si vjetërsi pune përpara moshës 15 vjeç, duke sugjeruar parashikim të shprehur ligjor për përfitimin e të lindurve apo atyre që ishin të mitur në internim, shoqëruar me parashikime të posaçme mbi mekanizmin e vërtetimit të qenies së personit të lindur apo të mitur në internim përmes verifikimit administrativ të dokumentacionit.

- ***Prioritizimi i rrethit të familjarëve për viktimat e vrara apo të ekzekutuara gjatë periudhës 30.11.1944-01.10.1991, ripërkufizimi dhe rishikimi i masës së dëmshpërblimit:*** sugjerohet vlerësimin e mundësisë së ndryshimeve në nenet 7 dhe 8 të ligjit nr. 9831/2007 me qëllim (1) harmonizim sa më të lartë të përkufizimit, në nenin 8, të *“rrethit të familjarëve”* dhe rrethit të trashëgimtarëve me Kodin Civil, për qëllime të përfitimit sipas nenit 7, si dhe (2) rishikimin e masës së dëmshpërblimit sipas nenit 7. Masa e dëmshpërblimit të mos barazohet me atë të 8 viteve burgim të padrejtë, por minimalisht me atë të dënimit maksimal me burgim 25 vite. Një ndryshim i tillë, nëse do të realizohej, do të duhej të shoqërohej edhe me rregullime të nevojshme tranzitore që mbajnë në konsideratë, ndër të tjera, përfitimet dhe përfituesit aktualë sipas dispozitave në fuqi dhe përfitimet që do të shtoheshin nga ndryshimi i dispozitës (përfshirë procedurën dhe afatin për një përfitim të tillë). Sugjerohet përfshirjen e kësaj kategorie në rrethin e kategorive prioritare.

- **Dëshmshpërblimet e mbetura**, për të cilat nisur edhe nga shqetësimet e grupeve të interesit, sugjerojmë përsëri, **përsheptimin e procesit të pagesës së dëshmshpërblimeve** të mbetura sipas kategorive prioritare dhe prioritizimit të kategorive.
 - **Shpërblim për punë të detyruar gjatë vuajtjes së dënimit**: Për të gjithë ish-të përndjekurit të cilët në kushtet e vuajtjes së dënimit kanë kryer edhe punë të detyruar (si për shembull në miniera) të konsiderohet mundësia e një pagese fikse mujore si shpërblim për punën e detyruar, e cila nuk prek përfitimet e tjera të deritanishme.
- d. Problematika të hasura lidhur me zbatimin sipas përcaktimeve të nenit 30 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” për verifikimin e pastërtisë së figurës të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku.**

Mosmarrja në konsideratë dhe mungesa e bashkëpunimit nga ana e partive politike apo koalicioneve të regjistruara në zgjedhjet parlamentare dhe ato vendore në kuadër të vlerësimit të pastërtisë së figurës të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshillash qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet prej tyre për qëllime të

transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 45/2015, shkakton moszbatimin e këtij neni. Për të përmbushur këtë detyrë nevojitet të bëhen **shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, shtesa në ligjin nr.8580, datë 17.2.2000 «Për partitë politike”, si edhe shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor.**

- e. Problematika të karakterit ligjor lidhur me identifikimin dhe rikuperimin e personave të zhdukur.**

Procesi i identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist përbën një detyrim të rëndësishëm të shtetit shqiptar për respektimin e të drejtave të familjarëve dhe parimeve të drejtësisë tranzicionale. Shteti shqiptar ka marrë përsipër të zbardhë fatin e personave të zhdukur, t’i identifikojë eshtrat dhe t’ua kthejë familjarëve të tyre për një varrim të denjë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Për të përmbushur këto detyrime, Shqipëria ka ratifikuar:

- **Konventën Ndërkombëtare të OKB-së për “Përmbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë”;**
- **Ligjin nr. 83/2018, Marrëveshjen me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).**

Në vijim, ndryshimet e bëra në ligjin nr. 45/2015 gjatë viteve 2020 dhe 2022 i japin Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) një rol në procesin e verifikimeve administrative, mbledhjes dhe analizimit të dëshmimeve dhe dokumenteve, si dhe në bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe vendore për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave dhe për mbrojtjen e vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara.

Megjithatë, zbatimi praktik i këtij kuadri ligjor ka hasur në boshllëqe dhe paqartësi që kanë ndikuar në mosrealizimin efektiv të procesit të kërkimit, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave.

Së pari, ligji nr. 83/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) nuk përcakton një rol të qartë për AIDSSH-në. Autoritet përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes nga pala shqiptare është Ministria e Brendshme, ndërsa AIDSSH nuk identifikohet si institucion me rol të përcaktuar në proces. Kjo ka krijuar paqartësi institucionale në drejtimin dhe koordinimin e veprimeve për kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur.

Së dyti, ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar i njeh AIDSSH-së kompetenca për mbledhjen dhe analizimin e informacionit, hetimet administrative dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe vendore, por nuk i jep autoritet/autorizim për të udhëhequr procesin, për të inici-

uar procedurat e gërmimeve ose për të koordinuar ndërhyrjet në terren. Për pasojë, roli i AIDSSH-së mbetet i paqartë dhe i kufizuar, ndërkohë që nuk përcaktohen autoritetet përgjegjëse dhe procedurat e bashkëpunimit me institucionet tjera.

Së treti, mungesa e aktit nënligjor (vendimi të Këshillit të Ministrave) që të rregullojë procedurat dhe ndarjen e përgjegjësive ndërmjet institucioneve ka penguar kalimin e procesit nga verifikimi i informacionit dhe identifikimi i vendvarrimeve drejt ndërhyrjeve konkrete për kërkimin, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur

Në këto kushte, lind nevoja për rishikimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor ekzistues, me qëllim qartësimin e kompetencave institucionale, përcaktimin më të qartë të rolit të AIDSSH-së dhe mundësimin e miratimit të akteve ligjore të nevojshme për zbatimin efektiv të procesit të kërkimit, identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur.

f. Problematika që burojnë nga ligji nr. 34/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, i ndryshuar.

Në Prill të vitit 2023, si rezultat i reformës së sistemit të pagave në administratën publike, ndryshuan edhe pagat dhe shpërblimet e të zgjedhurve

të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, të cilat rregullohen me ligj të posaçëm.

Për këtë qëllim u miratua Ligji nr. 34/2023 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar. Në ligjin e sipërcituar në lidhjet përkatëse bashkëlidhur atij u reflektuan dhe ndryshimet në pagat e Anëtarëve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Njëherazi ndryshimi i pagave për nëpunësit civilë pjesë e strukturës së institucionit të AIDSSH-së dhe ndryshimi i ligjit të sipërcituar për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, solli një prishje të hierarkisë dhe disproporcionalitetit mes nivelit të pagave të Anëtarëve të AIDSSH-së dhe pagave të punonjësve të administratës brenda institucionit, ku për një pjesë të pozicioneve të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues, pagat e këtyre të fundit tejkaluan pagën e një Anëtari të organit kolegjal në AIDSSH. Ky rezultat erdhi si pasojë e ndryshimit të Ligjit nr. 34/2023 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, ku në lidhjen bashkëlidhur atij, referenca e pagës së Anëtarëve të AIDSSH në raport me pagën e Presidentit të Republikës nga 55% që ishte, shkoi në 45%, e pagës së Presidentit, pra

është ulur saktësisht 10% dhe kjo diferencë bëhet më e dukshme në raport me gjithë institucionet e tjera të krijuara me ligj, duke na veçuar, duke mos ecur me rend progresiv si të gjithë institucionet e tjera por në rend regresiv, që është e papranueshme në lidhje me parimin për rritjen e pagave.

Sa më sipër, për të siguruar një strukturë të drejtë dhe të qëndrueshme pagash, duke shmangur disbalancat që demotivojnë punën dhe veprimtarinë e Anëtarëve të AIDSSH-së, nevojiten ndryshime në Ligjin nr. 34/2023 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, duke rishikuar koeficientin që ligji parashikon si referencë mbi pagën e Presidentit të Republikës, duke e ndryshuar atë nga 45% në 55% e pagës së Presidentit të Republikës.

Problematika në fjalë është paraqitur si në Komisionin e Ligjeve ashtu dhe në Komisionin “Nisma Qytetare” ku jemi thirrur për miratimin e buxhetit e AIDSSH-së të vitit 2026 dhe kemi marrë mbështetjen maksimale nga titullarët e këtyre komisioneve por jo vetëm, por edhe nga të gjithë deputetët e pranishëm të gjitha krahët politikë për rregullimin ligjor që kërkon zgjidhjen e problemit të paraqitur nga ana jonë. Gjithashtu dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financës në këto dy komisione janë dakortësuar për zgjidhjen e këtij problemi.

Njëherazi vlerësojmë se, për shkak dhe të angazhimit të anëtarëve të AIDSSH nëpër rrethe për të identifikuar të vendvarrimet dhe trupat e zhdukur dhe të pagjetur në periudhën komuniste, konstato-

het nevoja për ndërhyrje në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 ***“Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”*** i ndryshuar.

Propozohet që në listën e lidhjes nr. 2 të shtohet edhe Kryetari i AIDSSH, në mënyrë që të ketë të njëjtin trajtim të barabartë me homologët e tij dhe të jetë përfitues financiar i shërbimit të transportit në shumën 20,000 lekë/muaj, si dhe Anëtarët e Autoritetit si anëtarë të organit kolegjal si përfitues financiar të shërbimit të transportit në shumën 10,000 lekë/muaj.

The background is a solid light orange color. It features faint, grey Arabic calligraphy scattered across the surface. Two large, semi-transparent, light orange numbers, '1' and '2', are positioned behind the main text. The number '1' is on the left and the number '2' is on the right.

RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE

3. RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DE-TYRIMEVE NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi ndërinstitucional

- Bashkëpunimi me ICMP

Gjatë vitit 2025, bazuar në Protokollin mbi marrëveshjet praktike për koordinimin e zbatimit të projektit “Mbështetja e drejtësisë tranzicionale dhe trajtimi i së shkuarës në Shqipëri” ndërmjet AIDSSH-së dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), AIDSSH arriti rezultate të rëndësishme në avancimin e identifikimit dhe dokumentimit të vendvarrimeve të dyshuara për personat e zhdukur.

U realizuan vizita dhe vlerësime në terren në gjashtë vendvarrime të dyshuara në Shkodër, Mirditë, Selenicë, Himarë dhe Leskovik. Aktivitetet kërkimore u zhvilluan me metoda jo-invasive duke përdorur pajisjen Total Station në gjashtë vendvarrimet. dhe në tre prej tyre, përkatësisht dy në Mirditë dhe një në Himarë, metodën GPR (Ground Penetrating Radar), për verifikimin e vendvarrimeve dhe lokalizimin e vendeve me anomali me prani objektsh të ndryshme nga struktura si dhe ndryshime strukturore të natyrës së gërmimeve në të etj. U kryen edhe sondazhe në territor, duke marrë mostra pranë vendeve të dyshuara për analiza të tyre në laboratorë. Po ashtu, stafi mori trajnime të specializuara mbi procedurat e kërkimit dhe identifikimit të mbetjeve mortore, si dhe mbi përdorimin e sistemit iDMS. Ky sistem garanton

zhvillimin e databazës sipas standardeve ndërkombëtare, duke siguruar mbrojtjen, gjurmueshmërinë dhe auditueshmërinë e të dhënave.

Bashkëpunimi me Rrjetin Evropian të Policive Sekrete, ku shkëmbehet ekspertizë për çështje të interesit të përbashkët. Në maj 2025, një ekip i Autoritetit zhvilloi një vizitë studimore pranë Institutit të Kujtesës Kombëtare (IPN) në Varshavë, Poloni, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e kujtesës historike dhe trajtimit të së kaluarës. Në shtator, AIDSSH u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë në takimin vjetor të Rrjetit ku u diskutua mbi aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2025, ku kryesimin e kishte Polonia si dhe për zgjerimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Po në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Rrjeti, në 11 Qershor 2025, një anëtar i organit kolegjal dhe Drejtori i Arkivit morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare: “Arkivat dhe Kujtesa, Shfrytëzimi bashkëkohor i trashëgimisë arkivore të shërbimeve sekrete në ish - bllokun komunist.”

AIDSSH, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, ka nënshkruar gjashtë marrëveshje bashkëpunimi: me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF), Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Institutin Albanologjik të Prishtinës, Institutin e Historisë “Ali Hadri”, fondacionin “Kujto.al”, fondacionit “Konrad Adenauer”. Po kështu, në fazën e nënshkrimit është një marrëveshjeje bashkëpunimi midis AIDSSH dhe Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.



ZBATIMI I REZOLUTËS SË
KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E
VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
NË VITIN 2024

4. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT NË VITIN 2024

- a. **Rekomandim:** *“Të angazhohet në digjitalizimin dhe skanimin e plotë të dokumentacionit arkivor për të garantuar ruajtjen afatgjatë dhe aksesin publik të dokumenteve.”*

Në përputhje me Rezolutën e Kuvendit dhe strategjinë institucionale për ruajtjen afatgjatë të dokumentacionit, gjatë vitit 2025 është vijuar procesi i digjitalizimit dhe skanimit të fondeve arkivore.

➤ **Digjitalizimi në kuadër të kontratave të posaçme**

Në bazë të kontratës nr. 348/4 prot., datë 24.02.2025, janë realizuar shërbime digjitalizimi në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Procesi ka përfshirë fondet:

- Degë IV – dosjet e centralizuara;
- Degë IV – dosjet e drejtimit;
- Fondi Grupet;
- Fondi PPSH;
- Fondi Institutit;
- Fondi 6.

Në total janë digjitalizuar nëpërmjet skanimit **205,000 imazhe (188,715 fletë)**, duke garantuar mbrojtjen fizike të dokumentacionit gjatë procesit dhe krijimin e bazës për arkivin digjital.

- Shërbimi i dokumentacionit për skanim në funksion të kërkesave për informim, nga stafi i AIDSSH, Sektori i Digjitalizimit dhe Fotokopjes, pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, Digjitalizimit dhe Sigurisë.

Paralelisht me digjitalizimin në kuadër të kontratave, ka vijuar gjatë vitit 2025 edhe skanimi i dokumentacionit arkivor në funksion të kërkesave të legjitimuara në AIDSSH, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar. Në këtë proces **janë skanuar/digjitalizuar 16, 229 imazhe nga dosjet e fondëve arkivore të AIDSSH-s, 2,715 dublikata fotokopje nga kartela, regjistra, dosje personale, etj., si dhe janë përgatitur për drejtoritë përkatëse 204 CD/DVD me materiale arkivore të anonimizuar të cilat u janë përcjellë qytetarëve, studiuesve, medias, etj.**

Ky shërbim ka ndikuar drejtpërdrejt në lehtësimin e trajtimit të kërkesave për informim, në rritjen e qasjes të subjekteve kërkuese dhe në lehtësimin e punës së strukturave të tjera të AIDSSH-s.

- b. **Rekomandim:** *“Angazhimi për përfshirjen e pushtetit lokal në njohjen e rezultateve të verifikimeve administrative në njohjen e rezultateve të verifikimeve administrative lidhur me gjetjen e vendvarrimeve të dyshuara dhe mbrojtjen e vendvarrimeve të identifikuar.”*

Në përmbushje të rekomandimit si më sipër, janë ndërmarrë këto iniciativa:

- ✓ Raportet përmbledhëse të verifikimeve administrative janë përcjellë pranë (pesë bashkive, të cilat janë njohur zyrtarisht me gjetjet lidhur me vendvarrimet e dyshuara apo të identifikuara në territorin e tyre.
- ✓ Është forcuar bashkëpunimi ndërinstucional ndërmjet AIDSSH dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së vendvarrimeve.
- ✓ Është hartuar draft-marrëveshje bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim rregullimin e bashkëpunimit institucional për ruajtjen e vendvarrimeve dhe koordinimin e veprimeve për identifikimin e personave të zhdukur.
- ✓ Janë krijuar parakushtet institucionale për vijimin e fazave të mëtejshme të procesit të identifikimit, dokumentimit dhe mbrojtjes së vendvarrimeve të dyshuara.
- ✓ Të vijojë angazhimin për krijimin e një baze të vetme të dhënash për personat e zhdukur dhe ta bëjë atë publike e të aksesueshme për publikun.

c. Rekomandim: “Të vijojë angazhimin për krijimin e një baze të vetme të dhënash për personat e zhdukur dhe ta bëjë atë publike e të aksesueshme për publikun.”

AIDSSH ka nisur ngritjen e një data baze për viktimat e komunizmit, e cila po përditësohet periodikisht dhe po përdoret për të mbështetur hetimet administrative dhe punën operacionale të Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e

Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur.

- ✓ Data baza aktualisht menaxhohet nga kjo drejtori përmes një programi në Microsoft Suite, duke mundësuar administrimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave ekzistuese. Struktura aktuale e data bazës është lehtësisht e konvertueshme në formate të përshtatshme për integrim në Sistemin e Menaxhimit të Identifikimit të të Dhënave (iDMS), një platformë e avancuar për menaxhimin e të dhënave komplekse dhe sensitive.
- ✓ U vlerësua nga ana ligjore, Marrëveshja e Licencës së përdoruesit të iDMS ndërmjet AIDSSH dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), me qëllim zhvillimin e data bazës sipas praktikave dhe standardeve ndërkombëtare. Sistemi iDMS do të sigurojë përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, duke garantuar që të dhënat të jenë të mbrojtura, të gjurmueshme dhe të auditueshme, në funksion të qartësisht të fatit dhe identifikimit të personave të zhdukur.
- ✓ Ka përfunduar trajnimi i stafit për përdorimin e sistemit iDMS.

Po punohet për përditësimin periodik dhe popullimin me të dhëna të reja të databazës për personat e zhdukur, e cila po përdoret gjithashtu për të mbështetur hetimet administrative dhe punën operacionale.

d. Rekomandim: “Të intensifkojë bashkëpunimin me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit”.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar, VKM nr. 98/2017 dhe Rezolutës së Kuvendit, gjatë vitit 2025, Drejtoria e Arkivit ka vijuar procesin e grumbullimit dhe marrjes në administrim të materialeve arkivore që lidhen me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, përmes një qasjeje të strukturuar administrative dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

1. Veprimet administrative dhe shkresore

- Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar komunikime të shumta shkresore me objekt “Kërkesë për identifikim dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit arkivor, që lidhet me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit”, me institucionet mbajtëse të dokumentacionit arkivor, të tilla si DPA, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gjykata e Lartë, Tiranë.
- Për periudhën Janar-Dhjetor, janë organizuar takime midis Autoritetit dhe DPA, janë përgatitur relacionet përkatëse për në AIDSSH sipas procedurës.

Këto komunikime kanë synuar unifikimin e praktikave, qartësimin e përgjegjësive institucionale dhe përshejtimin e procedurave të kalimit të dokumentacionit arkivor nën administrimin e AIDSSH.

2. Rezultatet e arritura në grumbullim

Si rezultat i veprimeve të mësipërme, për periudhën janar–dhjetor 2025 janë grumbulluar dhe administruar:

- 12 fonde arkivore me 73 dosje në format CD;
- 1 fond arkivor me 13 dosje në format fotokopje.

Procesi i grumbullimit ka kontribuar në pasurimin gradual të fondit arkivor dhe në krijimin e një baze më të plotë dokumentare për trajtimin e kërkesave për informim dhe për proceset e mëtejshme arkivore.

Gjatë zbatimit të procesit të grumbullimit dhe marrjes në administrim të materialeve arkivore gjatë vitit 2025, është evidentuar një vështirësi e lidhur me ndryshimet në kuadrin ligjor për administrimin e dokumentacionit arkivor.

Konkretisht, ndërkohë që ishte vendosur një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme për grumbullimin e dokumenteve arkivore, ndryshimet ligjore kanë përcaktuar kalimin e këtyre dokumenteve nën administrimin e DPA-s. Për pasojë, gjatë vitit raportues komunikimet shkresore dhe veprimet administrative janë fokusuar në vendosjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucionale me DPA-në, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Kjo situatë ka ndikuar në ritmin e realizimit të procesit të grumbullimit, duke kërkuar kohë shtesë për përshtatjen dhe harmonizimin e procedurave ndërinstitucionale.

e. **Rekomandim: “Të konkretizojë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, me qëllim zbatimin korrekt të ligjit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh.”**

Është hartuar draft-marrëveshja me Ministrin e Pushtetit Vendor, e cila i është përcjellë me shkresë zyrtare Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor. Pritet konfirmimi për realizimin e një takimi pune të fokusuar në çështjet e trajtuara për bashkëpunim.

Në datë 21.02.2025 në prani të përfaqësuesve të Pushtetit Vendor, u prezantua “*Dialog i Autoritetit Për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me Pushtetin Vendor*”. Aktiviteti u zhvillua në Bibliotekën “Musine Kokalari”, duke vënë në dispozicion dokumentin e Dialogut “*Për modalitetet e punës me strukturat e pushtetit vendor*”.

Në datë 22.10.2025 në prani të përfaqësuesve të Pushtetit Vendor Gjirokastër, u prezantua “*Dialog i Autoritetit Për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me Pushtetin Vendor*”. Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Fato Berberi”, pjesëmarrësve iu vu në dispozicion dokumenti i Dialogut “*Për modalitetet e punës me strukturat e pushtetit vendor*”.

Në datën 11. 12 2025 në bashkëpunim me Bashkinë e Pogradecit, u zhvillua takimi i radhës i Dialogut të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me pushtetin vendor me shumë pjesëmarrës dhe diskutime.

f. **Rekomandim: “Në kuadër të edukimit qytetar, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit të angazhohet për të përfshirë në programin mësimor, orë ekstrakurrikulare në shkolla, me qëllim edukimin e të rinjve për të kaluarën komuniste dhe pasojat e saj.”**

Në vijim të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit nga AIDSSH janë dërguar shkresa zyrtare për Ministrinë e Arsimit dhe ISKK-së me fokus rezolutën e datës 9.11.2025. Zbatimi i rekomandimeve për shkak të periudhës së shkurtër që nga koha kur janë dhënë (më pak se 2 muaj kalendarikë të vitit 2025) do të vijojë gjatë vitit 2026.

Në vijim të edukimit qytetar, gjatë vitit 2025 është zhvilluar Turi i Leximit dhe Informimit, që ka pasur në fokus takime informuese në shkollat e vendit me qëllim njohjen e brezit të ri me regjimin komunist në Shqipëri, shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë diktaturës dhe të tjera tema nëpërmjet botimeve të AIDSSH për arsimin parauniversitar. Turi është realizuar në bashkëpunim me MA dhe KiE-n në Tiranë.

g. **Rekomandim: “Të angazhohet në bërjen funksionale të Mediatekës (Platforma online e arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit), me qëllim promovimin e materialeve arkivore dhe dokumenteve historike për të lehtësuar studimin dhe informimin për periudhën e diktaturës në Shqipëri, si dhe rritjen e aksesit në dokumente nga ana e institucioneve arsimore.”**

Gjatë vitit 2025 u ndërmorën veprimet e mëposhtme për të bërë funksionale Mediatekën (platforma online e arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit), sipas objektivave të Planit Strategjik 2023-2028:

- U hartuan dhe miratuan Termat e Referencës nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Digjitalizimit dhe Sigurisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Informacionit, pasi u konsultuan dhe me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.
- U realizua kontraktimi i kompanisë zbatuese dhe u siguroa ndërtimi i platformës dhe funksionaliteteve të saj nga ana teknike.
- U realizua trajnimi i përdoruesve mbi mënyrën e regjistrimit të të dhënave në platformë.

AIDSSH synon të thellojë këto përpjekje gjatë vitit 2026 përmes perfeksionimit të platformës digjitale (MEDIATEKA), nëpërmjet rritjes së aksesit në dokumente dhe zgjerimit të rrjetit të bashkëpunimeve me media dhe institucione arsimore



**OBJEKTIVA DHE INDIKATORË
TË SYNUAR PËR 2025**

5. OBJEKTIVA DHE INDIKATORË TË SYNUAR PËR 2025

1. Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për financimin dhe asistencën teknike të vijueshme në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur;
2. Zgjerimi i hetimeve administrative dhe aplikimi i mjeteve/logjistikës bashkëkohore për detektimin e eshtrave në 2 vendvarrime të dyshuara nëpërmjet bashkëpunimit me ICMP;
3. Ngritje e kapaciteteve: në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) nëpërmjet trajnimit të stafit të drejtorisë përgjegjëse, për përdorimin e platformës ndërkombëtare “Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të Integruara” (iDMS), i cili përdoret sot nga shumica e shteteve që kanë problematika lidhur me personat e zhdukur. Synohet që në gjashtëmuorin e parë të vitit 2025 të jetë përmbushur detyra e caktuar nga rezoluta e Kuvendit, duke përdorur tre modulet e para të iDMS, përmes kalimit në to të informacionit që ka mbledhur AIDSSH në databazën e të dhënave:
 - Moduli i parë ka të bëjë me të dhëna mbi personat e zhdukur;
 - Moduli i dytë ka të bëjë me të dhëna rreth familjarëve e trashëgimtarëve të personave të zhdukur;
4. Startim i implementimit të dy projekteve për ngritjen e memorialeve të kujtesës në bashkëpunim me pushtetin vendor në Shkodër dhe Ersekë;
5. Rritje e efikasitetit të veprimtarisë së AIDSSH-s nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me pushtetin vendor për çështje që lidhen me të zhdukurit, kujtesën, aktivitetet me karakter edukues dhe ndërgjegjësues;
6. Rritja e aksesit virtual të publikut përmes kontraktimit, vënies në punë bërjes funksionale të platformës online (Mediateka);
7. Intensifikimi i punës ndërgjegjësuese me pushtetin vendor me qëllim përfshirja e të 61 bashkive në fund të vitit 2028 në proceset e verifikimit të figurave, nga 26 të përfshira aktualisht përmes fushatave të dialogut dhe bashkëpunimit;
8. Digjitalizimi i 75-80 % të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit deri në vitin 2028. Aktualisht është digjitalizuar rreth 33 %;
9. Deklasifikimi i 80 % dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit deri në fund të vitit 2028;
10. Rritja e efikasitetit të trajtimit të kërkesave të ardhura nga individë, qytetarë, institucione studiues etj.



VEPRIMTARIA
E STRUKTURAVE

6. VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE

6.1 ARKIVI

Inventarizimi i dokumenteve arkivore

Në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, të ndryshuar, dhe në zbatim të normave tekniko-shkencore të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Arkivit ka vijuar gjatë periudhës raportuese procesin e inventarizimit të fondeve arkivore të administruara nga AIDSSH.

Procesi i inventarizimit ka përfshirë verifikimin e gjendjes faktike të dokumentacionit arkivor, evidencimin e përmbajtjes dhe volumit të materialeve arkivore, si dhe përditësimin e të dhënave përkatëse në përputhje me standardet arkivore në fuqi.

Ky proces është parashikuar në planin e punës për vitin 2025 dhe vijon në zbatim të planit të punës për vitin 2026, duke garantuar vazhdimësi metodologjike dhe qëndrueshmëri në administrimin profesional të fondeve arkivore.

Ruajtja dhe shërbimi i dokumenteve arkivore

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Drejtoria e Arkivit ushtron funksionet e saj themelore për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shërbimin e materialeve

arkivore, në zbatim të Ligjit nr. 45/2015, Ligjit nr. 9154/2003 “Për arkivat” dhe Ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.

Në këtë kuadër, garantohet integriteti fizik dhe përmbajtësor i dokumenteve, përmes administrimit të tyre në ambiente të sigurta dhe në përputhje me standardet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shërbimi ndaj subjekteve të interesuara realizohet në bazë të procedurave ligjore të verifikimit, klasifikimit dhe deklasifikimit, duke respektuar parimet e transparencës, të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Deklasifikimi

Procesi i deklasifikimit është zhvilluar në përputhje me standardet dhe angazhimet ndërkombëtare, përfshirë rekomandimet e projekt-rezolutës së Parlamentit Evropian mbi raportin e Komisionit për Shqipërinë për vitin 2022, ku theksohet nevoja për përfundimin e deklasifikimit të dokumenteve të periudhës së komunizmit dhe garantimin e aksesit për publikun dhe studiuesit, në funksion të drejtësisë dhe pajtimit.

Në përputhje me Planin Strategjik 2023–2028 të AIDSSH-s, procesi i deklasifikimit parashikohet të përfundojë brenda vitit 2028 dhe realizohet në bazë të planit të punës të miratuar, sipas listave të inventarëve të dokumenteve arkivore dhe në funksion të trajtimit të kërkesave sipas rendit të përparësisë.

Ecuria për vitin 2025

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë marrë gjithsej 8 vendime ku;

- 7 vendime janë miratuar;
- 1 vendim është pezulluar.

Në bazë të vendimeve të miratuara janë deklasifikuar:

- 5,207 njësi arkivore (dosje, fashikuj etj.);
- 390,690 fletë dokumente arkivore.

Ecuria për vitin 2024

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2024 janë marrë vendime si më poshtë;

- 32 vendime;
- 17,303 njësi arkivore;
- 1,096,699 fletë dokumente arkivore.

Nga analiza krahasimore e të dhënave për vitet 2024 dhe 2025 evidentohet një rënie e ndjeshme në ritmin e realizimit të procesit të deklasifikimit. Kjo rënie lidhet kryesisht me ndryshimet procedurale të parashikuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, veçanërisht në Ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe në VKM nr. 822, të cilat kanë sjellë shtimin e fazave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe përfshirjen e aktorëve shtesë institucionalë në këtë proces.

Në mënyrë të veçantë, procedurat e reja kërkojnë përfshirjen e institucionit trashëgues të informacionit dhe miratimin përfundimtar nga titullari i

institucionit përkatës, duke e zhvendosur vendimmarrjen përfundimtare jashtë kompetencës së komisionit të deklasifikimit dhe duke rritur kompleksitetin e procesit.

Në këtë kuadër, dhe me qëllim përshtatjen me kërkesat e reja ligjore dhe garantimin e vijimësisë së procesit, Autoriteti ka ndërmarrë masa organizative dhe procedurale, duke miratuar urdhrin nr. 273, datë 10.11.2025, “Për ngritjen e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit”, si dhe vendimin nr. 624, datë 19.12.2025, “Për marrjen në shqyrtim të modelit të vendimit për informacionin sekret shtetëror të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në AIDSSH”.

Këto masa kanë synuar harmonizimin e praktikës institucionale me kuadrin e ri ligjor, përmes krijimit të një strukture dhe metodologjie të qartë për vlerësimin, renditjen dhe evidentimin e dokumenteve, në funksion të vijimit të procedurave të deklasifikimit.

Në këtë kontekst, ecuria e procesit gjatë vitit 2025 është ndikuar nga faktorë të jashtëm që lidhen me ndryshimet ligjore dhe procedurat e reja në fuqi. Për rrjedhojë, ritmi i realizimit nuk lidhet me performancën e strukturave të Autoritetit, por me kërkesat dhe kohëzgjatjen e procedurave të përcaktuara nga kuadri i ri ligjor.

Shërbimi i dokumentacionit për skanim në funksion të kërkesave për informim

Paralelisht, gjatë vitit 2025 ka vijuar edhe skanimi i dokumentacionit arkivor në funksion të trajtimit të kërkesave të paraqitura pranë Autoritetit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar.

Në këtë kuadër janë realizuar:

- **16,229 imazhe të skanuara/digjitalizuara** nga dosjet e fondeve arkivore;
- **2,715 dublikata fotokopje** nga kartela, regjistra dhe dosje personale.

Ky proces kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë.

Trajtimi i kërkesave:


Rezulton se gjatë vitit 2025 janë përfunduar në total **852 kërkesa**, të shpërndara sipas tipologjive përkatëse, ku peshën më të madhe e zënë kërkesat individuale (336), të ndjekura nga ato për internim/

debim (179), studimore (140), institucionale (99), për persona të zhdukur (71) dhe për zbardhje bashkëpunëtorësh (27).

Megjithatë, një pjesë e kërkesave nuk kanë mundur të përfundojnë plotësisht brenda afateve përkatëse, për shkak të varësisë direkte nga procesi i deklasifikimit të dokumenteve arkivore.

Në këtë kuadër, evidentohet se ecuria e trajtimit të kërkesave lidhet ngushtësisht me ritmin e procesit të deklasifikimit, i cili gjatë vitit 2025 ka shfaqur një rënie të ndjeshme krahasuar me vitin 2024.

Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në kohën e kthimit të përgjigjeve për një kategori kërkesash, veçanërisht ato që kërkojnë akses në dokumente ende të klasifikuara. Megjithatë, deri më tani, Drejtoria e Arkivit, në kuadër të trajtimit të kërkesave, **ka shërbyer 250.442 fletë dokumente arkivore.**



Krijimi i arkivit të Kartotekës

Gjatë vitit 2024, u përfundua ngritja dhe organizimi funksional i Kartotekës si instrument bazë për administrimin dhe kërkimin arkivor. Procesi përfshiu instalimin e **45 rafteve**, sistemimin alfabetik të **44,179 kartelave model 1** dhe krijimin e një baze elektronike me **204,532 të dhëna**, duke përmirësuar ndjeshëm aksesin dhe kërkimin arkivor.=

Gjatë vitit 2025, vijoi përpunimi i kartelave model 2, ku:

- u evidentuan dhe numëruan **67,962 kartela** (28 sirtarë, Degë IV);
- u realizua renditja alfabetike dhe identifikimi i nivelit të klasifikimit;
- u përgatitën draft-relacione për deklasifikim.

Paralelisht, në Degët e Punëve të Brendshme dhe Degën IV janë evidentuar rreth **179,706 kartela** (model 1, 2 dhe 3), ndërsa identifikimi i plotë vijon sipas procesit të inventarizimit.

Hartimi i mjeteve të reja të kërkimit

Është përfunduar hedhja e të dhënave për **69 regjistra Model 1**, me gjithsej **1,373,911 fusha të dhënash**, duke krijuar një bazë të strukturuar për kërkimin arkivor.


Kategoria e kontigjenteve (Model 3):

Kategorinë e kontigjenteve (Model 3), procesi është zhvilluar në mënyrë të organizuar, ku:

- janë identifikuar **34 regjistra** në **18 rrethe**;
- janë evidentuar **1,872 fletë të plotësuara**;
- janë regjistruar **91,371 emra**;

Në vijim, parashikohet krijimi i rreth 1,005,081 të dhënave arkivore, duke plotësuar 11 fusha për çdo emër, me qëllim ndërtimin e një sistemi të avancuar kërkimi dhe administrimi të informacionit arkivor.

Kategoria e përpunimeve (Model 1):



6.2. INFORMIMI I INDIVIDËVE DHE QYTET-ARËVE

Kërkesat individuale nga palë të prekura, të treta, bashkëpunëtorëve dhe të favorizuarve:

Ndërmjet të tjerash, objekti dhe qëllimi kryesor i veprimtarisë së Autoritetit është të sigurojë të drejtën e çdo qytetari për të parë informacionin e krijuar ose të mbledhur për të nga ish-Sigurimi i Shtetit. Ofrimi i aksesit në këto dokumente, bazuar lejimeve dhe kufizimeve ligjore, mbetet prioritet i Autoritetit.


Në periudhën Janar – Dhjetor 2025:

- Janë regjistruar në Autoritet 508 kërkesa individuale, 5 kërkesa më shumë se gjatë 2024;
- Janë trajtuar/mbyllur gjithsej 491 kërkesa, nga të cilat:


kërkesa të regjistruara gjatë 2025

124 kërkesa të regjistruara gjatë 2024

11 kërkesa të regjistruara gjatë 2019-2023



Informacion i krahasuar ndër vite i përmbledhur në formë grafike:



Deri më 31.12.2025 janë regjistruar në total në AIDSSH 4209 kërkesa individuale dhe janë mbyllur 4038 ose 96% e kërkesave individuale, duke mbajtur të njëjtin nivel realizimi me vitin 2024 kur deri më 31.12.2024 kanë hyrë në total në Autoritet 3701 kërkesa individuale dhe janë mbyllur 3547 ose 96% e kërkesave individuale.

Mesatarisht afatet kohore të mbylljes së praktikave janë si më poshtë:

	kerkesa te hyra gjate vitit	kerkesa te mbyllura brenda vitit	%	Tot. kerk. te viteve kaluara te mbyllur ne ate vit	afatet kohore te mbylljes se praktikave /mesatarisht		koha e pergjigjeve te DA / mesatarisht	
					me te dhena	pa te dhena	me te dhena	pa te dhena
2025	508	356	70	158	4.9 muaj	1.4 muaj	1.4muaj	0.6 muaj
2024	503	362	72	173	4.1 muaj	1.8 muaj	1.8 muaj	1.2 muaj
2023	457	330	72	179	3 muaj	1 muaj	1 muaj	0.5 muaj
2022	555	371	67	204	4.7 muaj	1.9 muaj	2.4 muaj	0.7 muaj

Përpunimi dhe anonimizimi i dokumenteve

Gjatë 2025, për sektorin e kërkesave të palëve të prekura, të treta, bashkëpunëtorëve dhe favorizuarve ka mbetur prioritet edhe ruajtja e standarteve për informim dhe dorëzim të dokumentacionit arkivor dhe njëkohësisht mbrojtjes së të dhënave personale gjatë procesit të anonimizimit.

2025 - janë përpunuar 105030 faqe nga të cilat 13454 faqe të anonimizuara;

2024 - janë përpunuar 80474 faqe nga të cilat 27248 faqe të anonimizuara;

2023 - janë përpunuar 98.214 faqe nga të cilat 27.000 faqe të anonimizuara.

Trajtimi i Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbi-meve Rehabilituese

Për vitin 2025 janë trajtuar **gjithsej 223 kërkesa** (krahasuar me **216** kërkesa trajtuar në vitin 2024).

Kërkesa për internim/burgim/dëbimet për efekt të rritjes së pensionit: **210 kërkesa për 2025** krahasuar me **208** kërkesa për vitin 2024.

Nga këto 210 kërkesa:

- **29 kërkesa** (ose 13.81%) për efekt pensioni kanë ardhur për shtetas që kanë vuajtur **në burgje** (krahasuar me 56 kërkesa për vitin 2024);
- 181 kërkesa (ose 86.19%) për efekt pensioni kanë ardhur për shtetas që kanë vuajtur **internim /dëbim** (krahasuar me 152 kërkesa për vitin 2024).

Nga 210 kërkesat e paraqitura për burgim/internim:

- **108 kërkesa** (ose 51.43%) rezultojnë **pa të dhëna arkivore** (krahasuar me 95 kërkesa pa të dhëna në vitin 2024);
- **102 kërkesa** (ose 48.57%) janë **me të dhëna arkivore**, (krahasuar me 113 kërkesa me të dhëna për vitin 2024) (ose 54.3%);

Nga 210 kërkesa të ardhura:

- **130 kërkesa** (ose 61.9%) janë paraqitur nga individë, (krahasuar me 159 kërkesa nga individë në vitin 2024);
- **80 kërkesa** (ose 38.1%) janë paraqitur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (krahasuar me 49 kërkesa për vitin 2024);


13 kërkesa të ardhura në kuadër të kërkesave “nga çdo person - Neni 20.1.1, i Ligjit 45/2015”, (krahasuar me 8 kërkesa të vitit 2024), nga të cilat 5 janë në proces , ndërsa 7 janë praktika të mbyllura, me një realizim prej 53.9%;

Krahasim me vitin 2024


Numri Total i Kërkesave




Kërkesat për Efekt Pensioni



Kërkesat Sipas Burimit



Faqet e Dokumentacionit të Lexuar



MEDIATEKA

Platforma “Mediateka” e AIDSSH (<https://mediateka.aidssh.al/s>) përfaqëson një arritje thelbësore institucionale, si një platformë e krijuar për herë të parë me synimin për të sistematizuar, ruajtur dhe bërë të aksesueshme për publikun dhe studiuesit, të dhënat arkivore të krijuara nga Sigurimi i Shtetit gjatë periudhës 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991. Është një platformë publike dokumentare, e cila shfaq online për publikun, një përzgjedhje të materialeve arkivore, që administrohen nga AIDSSH, të prezantuara në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aksesin në dokumente. Kjo platformë nuk synon të zëvendësojë arkivin, por të shërbejë si një hyrje orientuese dhe shpjeguese drejt një fondi arkivor shumë më të gjerë, i cili mbetet i aksesueshëm përmes kërkimit të drejtpërdrejtë pranë arkivit fizik të AIDSSH-s, në përputhje me procedurat dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Në kuadër të përpjekjeve për ngritjen dhe funksionalizimin e saj, viti 2025 shënoi një etapë të rëndësishme në konsolidimin institucional dhe përgatitjen e bazës së nevojshme strategjike, normative dhe përmbajtësore të platformës “Mediateka” nëpërmjet ndërtimit të kornizës së qartë të veprimtimit për të garantuar funksionimin ligjor, etik dhe operativ të platformës.

-Janë përgatitur dokumentet themelore si udhëzimet e funksionimit, planet afatshkurtra e afatmesme operative, kushtet e përdorimit dhe formularët e aksesit si dhe termat e referencës qoftë të aspektit teknik të IT, qoftë të përfshirjes së ekspertëve për konsolidimin e përmbajtjes.

-U rishikua kalendari i Kujtesës, u strukturuan dhe u indeksuan dokumentet arkivore dhe u krijua databaza me ngjarje historike të shoqëruara me kryqëzim të dhënash arkivore (p.sh. cilat janë dokumentet për ngjarjen e caktuar, cilët studiues kanë kërkuar më herët për të, çfarë informacioni ekziston për llogari të strukturave të tjera në AIDSSH etj.)

-Procesi i konsultimit është realizuar me një qasje të kujdesshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i dhënë prioritet konsultimit me shumë pale (si AK-SHI, struktura të ngjashme me organizatat e huaja homologe), duke siguruar që çdo aktor relevant të ketë mundësinë të japë kontributin e tij duke bashkuar ekspertizën e sektorëve / institucioneve të ndryshme për të garantuar harmonizimin e standardeve teknike, ligjore dhe operative.

-Është kërkuar gjetja e formës më të mirë për strukturën e platformës, duke krahasuar dhe analizuar modelet e ndryshme të konsultuara, për të arritur një zgjidhje optimale dhe funksionale. Struktura e platformës Mediateka është bazuar në strukturën e platformës arkivore të STASSI-t Gjerman, por dhe në platforma të tjera si ajo polake apo e CIA-s, platforma të cilat kanë ngjashmëri tematike me Mediatekën e AIDSSH.

- Gjatë vitit 2025 u realizua me sukses procesi i prokurimit dhe u përzgjodh kompania zbatuese për implementimin e platformës, me një vlerë totale prej 2,970,000 lekësh. Kontrata me këtë kompani u nënshkrua më 30 tetor 2025, duke shënuar edhe fillimin zyrtar të punës për ndërtimin e platformës. Aktualisht, (në mars 2026), procesi i zhvillimit është në vijim, duke reflektuar progres të qëndrueshëm në përputhje me fazat e parashikuara të zbatimit.

Një nga shtyllat kryesore të platformës Mediateka, është organizimi i hedhjes së të dhënave arkivore sipas standardeve të mirëpërcaktuara të metadatave, duke garantuar strukturim, kërkueshmëri dhe ndërlidhje efikase të informacionit.


Platforma është ndërtuar mbi një arkitekturë funksionale menush, ku veçohet menuja “Njësi arkivore” si boshti kryesor, e cila synon hedhjen e indeksit arkivor si burim primar dhe lidhjen e tij të drejtpërdrejtë me dokumentacionin përkatës.

Krahas saj, janë ngritur edhe menu të dedikuara si “Figura”, “Ngjarje”, si dhe një hapësirë e posaçme mbi Sigurimin e Shtetit dhe strukturën e tij, ku një zë i veçantë “Aparati represiv” i dedikohet identifikimit të individëve që kanë ushtruar, miratuar apo gjykuar padrejtësisht viktimat e sistemit. Po ashtu,

platforma përfshin menutë “Vende të vuajtjes” (burgjet dhe kampet apo qendrat e internimit) dhe “Zërat e rezistencës”, kjo e fundit e konceptuar për të evidentuar individët që i janë kundërvënë regjimit. Në funksion të dokumentimit të kujtesës historike, është krijuar edhe menuja “Kujtesa”, ku pasqyrohen aktivitetet përkujtimore, dëshmitë dhe materialet mbi figurat dhe ngjarjet e lidhura me vuajtjet gjatë sistemit komunist (kryesisht realizuar nga AIDSSH por jo vetëm), si dhe menuja “Multimedia”, e cila shërben për publikimin e materialeve shoqëruese audio-vizuale.

Një element novator i platformës është edhe integrimi i një formati kontributi për publikun, përmes të cilit familjarë, persona të prekur, studiues dhe të interesuar të tjerë mund të kontribuojnë me dëshmi, metadata dhe të dhëna shtesë për figura dhe ngjarje të ndryshme, duke e kthyer Mediatekën në një hapësirë gjithëpërfshirëse dhe dinamike të kujtesës kolektive.

Deri në momentin e dorëzimit zyrtar të këtij raporti, po vijon puna për “popullimin” e Mediatekës me materiale arkivore nga sektori përgjegjës. Konkretisht, janë lexuar gjithsej 4,567 faqe dokumentacioni, nga të cilat 93 faqe dhe materiale fotografike janë përzgjedhur, shqyrtuar, miratuar, anonimizuar dhe ngarkuar në platformë në përputhje me planin e kalendarit të Kujtesës. Paralelisht, janë shqyrtuar edhe 4,102 faqe të tjera dokumentacioni, nga të cilat 198 faqe janë përzgjedhur dhe pritet të ngarkohen në vijim.



6.3 VERIFIKIMI I FIGURAVE

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve institucionale, për vitin 2025 ka vijuar puna për përmbushjen e objektivave të Autoritetit sidomos në kuadër të krijimit të lehtësimit në procedurat për institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike që kërkojnë informacion për:

- verifikimin e zyrtarëve që konkurrojnë për t'u zgjedhur ose emëruar në detyra publike, apo kandidatëve në zgjedhje.
- Verifikimin dhe informimin në kuadër të dekorimit, titujve të nderit të shtetasve dhe propozimeve të emërimit të hapësirave publike me emra personalitetesh, kërkesa të paraqitura nga institucionet dhe autoritetet publike (Pushteti Vendor dhe Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve)
- Verifikimi i figurave historike/ figurës së personave mbajtës të funksioneve politike e të aparatit shtetëror të kohës, duke analizuar dhe argumentuar rolin, kontributin dhe veprimtarinë e ushtruar nga secili prej tyre.


Përmes analizës së të dhënave dhe përpunimit të dokumenteve arkivore, është siguruar një proces transparent dhe i besueshëm, duke përmbushur në kohë kërkesat ligjore dhe nevojat e institucioneve shtetërore e publike.

Në total për periudhën Janar – Dhjetor 2025, në Autoritet janë paraqitur 128 kërkesa për verifikimin e 253 kandidatëve, janë verifikuar gjithsej 242 kandidatë nga të cilët vetëm për 15 prej tyre rezultojnë dokumente, pra figurojnë në dokumente të ish-sigurimit të shtetit si bashkëpunëtorë të ish Sigurimit të Shtetit, si ndihmës gjyqtarë, hetues dhe dëshmitar në procese politike dhe janë marrë 123 vendime. Janë shqyrtuar në funksion të mbylljes së procedurës për kandidatët gjetjet arkivore, gjithsej 22.400 faqe dokumentesh të digjitalizuara apo fizike. Gjithashtu, për arritjen e përfundimeve sa më të sakta është studiuar edhe kuadri ligjor i periudhës së veprimtarisë. Në raport me vitin 2024, ka rritje në numrin e kërkesave institucionale 128 nga 82 në vitin 2024. Numri i kandidatëve të verifikuar është afërsisht në të njëjtat nivele në të dy vitet: 242 nga 251 kandidatë.

Paraqitja tabelare krahasimore me vitin 2024:

Viti	Nr. kërkesa	Nr. kandidat për verifikim	Nr kandidat verifikuar	Kandidatë pa të dhëna	Figurojnë me gjetje	Nr.vendime
2025	128	253	242	227	15	123
2024	82	263	251	226	25	92

Viti 2025 Subjektet kërkuese në %




Nga 128 kërkesa të reja të paraqitura dhe të legjitimuara në Autoritet, 42 prej tyre pra 30 % u përkasin kërkesave të paraqitura nga 22 bashki, nga 18 bashki në vitin 2024. Nga ana e organeve të pushtetit vendor janë vlerësuar tre aktivitetet ku u prezantua “Dialogu i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me Pushtetin Vendor”, në Tiranë, Gjirokastrë dhe Pogradec me përfaqësues të Pushtetit Vendor.

Nga 242 kandidatë të verifikuar, 115 prej tyre ose 48% e numrit të kandidatëve janë shtetas të propozuar për dhënie tituj nderi, dekorata ose në kuadër të propozimeve për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike.

Nga 123 vendime, 53 prej tyre i përkasin kërkesave të pushtetit vendor. Nga 15 kandidatë që figurojnë me gjetje, 12 prej tyre, i përkasin procedurave verifikuese sipas objektivit të kërkesave të bashkive si b.p., ndihmës gjyqtar dhe 1 si dëshmitar, pra janë shtetas të propozuar për emërtim rrugësh, hapësirash apo dekorim dhe dhënie titulli nderi.

Përveç kërkesave të pushtetit vendor për verifikim të kandidatëve të propozuar për emërtimin e disa hapësirave të territorit publik, tituj nderi apo dekorim të shtetasve, Autoriteti ka kryer brenda afateve të kërkuara nga institucionet, procedurat për vlerësim të cilësive etike morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar apo zgjedhur në/nga Kuvendi



i Republikës së Shqipërisë, Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kryeministria Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Ministria e Drejtësisë, QKLL, Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, dhe kërkesat për verifikimin e kandidatëve nga Departamenti i Administratës Publike, ISKK apo RTSH.

Bashkëpunimi me Pushtetin Vendor

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2025 krahasuar me vitin 2024, më shumë organe të pushtetit vendor kanë vlerësuar zbatimin korrekt të ligjit nga ana e Autoritetit dhe kanë bashkëpunuar, për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dhënien e titujve të nderit, dekorim apo edhe propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh, gjithsej 22 bashki nga 61 prej tyre kanë bashkëpunuar.

Bashkëpunimi me Subjektet politike me rastin e zgjedhjeve parlamentare.

Pavarësisht shkresave të drejtuara gjithë subjekteve politike (53 subjekte të regjistruara të cilave ju dërgua shkresa me qëllim që të marrin në konsideratë këtë proces të rëndësishëm për integritetin e zgjedhjeve, në kuadër të vlerësimit të pastërtisë së figurës të kandidatëve për deputet për qëllime të transparencës së figurës së tyre gjatë fushatave elektorale) vetëm 6 kandidatë me iniciativë personale kanë paraqitur kërkesë për verifikim. Vijon të mbetet problematike mungesa e bashkëpunimit nga ana e partive politike apo koalicioneve të regjistruara në zgjedhjet parlamentare për zbatimin e nenit 30 të ligjit nr. 45/2015.

6.4 MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË DIKTATURËS

Procesi i identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur në Shqipëri përbën një shtyllë thelbësore të drejtësisë tranzicionale dhe ruajtjes së kujtesës historike.

Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur (DMNPIRPZH) vepron mbi bazën e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar. Nenet 19, 22 dhe 22/1 përcaktojnë detyrat për koordinimin institucional, qartësimin e fatit dhe bashkëpunimi me qëllim, indentifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur, si dhe ruajtjen e vendvarrimeve. Ligji garanton bashkëpunimin ndërinstitucional, duke mundësuar akses në dokumentacion dhe hetimin e fatit të të zhdukurve.

Rekomandimet e organizatave ndërkombëtare (OKB, OSBE, ICMP, BE) kanë theksuar nevojën për një strategji të unifikuar kombëtare, përdorimin e teknologjive dhe metodave moderne të kërkimit, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 u shënuan **arritje të prekshme:**

- Kryerja e kërkimeve me metoda jo-invazive në 6 vendvarrime të dyshuara (në bashkëpunim ICMP–AIDSSH).

- Nisja e 4 hetimeve të reja administrative për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, përcaktimi i 5 vendvarrime të reja të dyshuara.
- Realizimi i simpoziumit “Kufiri i shpresës dhe i vdekjes 1944–1991” në Shkodër më 28 gusht 2025, i cili afroi komunitetin lokal dhe familjarët, duke e shndërruar qytetin në një hapësirë dialogu për drejtësi tranzicionale dhe memorializim.
- Ka nisur funksionalizimi i sistemit iDMS në AIDSSH, përmes përfundimit të trajnimit të stafit dhe fillimit të përdorimit të tij në praktikë. Ky sistem mundëson administrimin e të dhënave në mënyrë të centralizuar, të standardizuar dhe të sigurt për rastet e personave të zhdukur, duke përmirësuar punën dhe efikasitetin e institucionit.
- Hartimi i udhëzuesit për qartësimin e fatit të personave të zhdukur.
- Ka nisur procesi i bashkëpunimit me Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave për përdorimin e teknologjive të avancuara jo-invazive në identifikimin e vendvarrimeve të dyshuara.
- Ka nisur procesi të hartimit të draft-marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor (Bashkitë), për ruajtjen dhe mbrojtjen e vendvarrimeve të dyshuara, i cili vijon të zhvillohet edhe aktualisht.

Përballë këtyre arritjeve, procesi has ende **sfida madhore:**

- Gjatë vitit 2025, një nga sfidat kryesore të Autoritetit ishte finalizimi i databazës së të

dhënave për personat e zhdukur gjatë regjimit komunist, proces i cili kërkoj standardizimin, verifikimin dhe harmonizimin teknik të informacionit të mbledhur ndër vite. Ky proces përfshiu përditësimin e të dhënave, pastrimin e tyre nga mospërputhjet, si dhe përshtatjen me kërkesat teknike të sistemit të integruar të menaxhimit të të dhënave (iDMS). Sfidat po adresohen me sukses dhe **finalizimi i databes në vijim**, duke mundësuar administrimin e unifikuar, të sigurt dhe të besueshëm të rasteve dhe duke përbërë një prej arritjeve të rëndësishme institucionale në vijën e punës së nisur gjatë vitit 2025.

- Mungesa e miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM), që do të përcaktonte përgjegjësitë e secilit institucion dhe do të mundësonte nisjen e gërmimeve praktike.
- Pa angazhimin e plotë të Ministrisë së Brendshme dhe koordinimin e saj me Ministrinë e Drejtësisë, qindra vendime të dyshuara mbeten të paprekura, duke rrezikuar humbjen e provave të çmuara.
- Kjo e bën **intensifikimin e lobimit për miratimin e VKM-së një domosdoshmëri urgjente**, pasi vetëm përmes këtij akti mund të hapet rruga për një proces të besueshëm dhe të standardizuar të rikuperimit dhe identifikimit.

Kërkesa të administruara 2025

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë administruar 69 kërkesa të administruara nga familjarët e personave të zhdukur duke e çuar kështu numrin kumulativ të kërkesave në 410. Numri i praktikave për legjitimim në Autoritet dhe proces verifikimi në

institucione është 63. Qytetarët janë asistuar në plotësimin e aplikimeve dhe janë trajtuar të gjitha verifikimet për legjitimim.

Statistika permbledhëse krahasimore 2022/2025

- 69 kërkesa të reja në 2025
- 16 vendime të dyshuara dhe identifikuar gjatë 2022-2025, përfshirë 5 të reja në vitin 2025.
- 4 vendime të reja për hetime administrative, duke e çuar numrin total në 13 për periudhën 2022-2025.
- Rritje e bashkëpunimit me institucionet vendase dhe ndërkombëtare për përshpejtimin e procesit të gjetjes së eshtrave.
- Rritje e ndërgjegjësimit publik për të denoncuar raste të personave të zhdukur dhe për të ndihmuar në procesin e dokumentimit.

Tabela 1. Numri i kërkesave për periudhën 2022-2025

Viti	Numri Kërkesave Total	Të Zhdukur Femra	Të Zhdukur Meshkuj	Të Zhdukur të Mitur
2025	69	0	63*	0
2024	59	0	59	0
2023	59	1	58	0
2022	96	3	94	2
Total	214	4	208	2

Verifikimet administrative dhe kërkimet në terren për identifikimin e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë Regjimit Komunist.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), ka zhvilluar verifikime në terren me metoda joinvazive për identifikimin e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë diktaturës.

Këto verifikime mundësuan evidentimin e anomalive nëntokësore me interes për kërkime të mëtejshme.

Rezultatet paraqiten si vijon:

1. Lukovë, Bashkia Himarë

Në zbatim të Vendimit nr. 620, datë 01.11.2024, Autoriteti zhvilloi verifikime administrative të thel-

luara për identifikimin e vendvarrimit të dyshuar pranë murit lindor të varrezave të fshatit Shën Vasil, në lidhje me personat Hasan Hysen Hamza, Fiqiri Qazim Marika dhe Zyhdi Sinan Çitaku.

Procedura u iniciua mbi bazën e kërkesave të familjarëve dhe u mbështet në verifikime arkivore pranë Drejtorisë së Arkivit të Sistemit në Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Nga analiza e dokumentacionit arkivor, evidencave penitenciare, dëshmime familjare dhe verifikimeve në terren rezulton se territori përgjatë murit lindor të varrezave përbën një vendvarrim të identifikuar të personave që kanë humbur jetën gjatë vuajtjes së dënimit në periudhën e regjimit komunist. Sipas dokumentacionit disponues, në këtë zonë janë varrosur të burgosurit që kanë ndër-ruar jetë në Kampin e Punës së Detyruar (Reparti 305).

Në kuadër të bashkëpunimit me International Commission on Missing Persons (ICMP), u realizuan ekzaminime në terren me metoda jo-invasive. Raporti ICMP-se identifikon anomali nëntokësore që sugjerojnë ndërhyrje antropogjene dhe rekomandon vijimin e kërkimeve përmes gjurmimeve.

2. Mallkeq dhe Bolenë, Njësia Administrative Vlahinë, Bashkia Selenicë

Në zbatim të Vendimit nr. 617, datë 24.10.2024, Autoriteti zhvilloi verifikim administrativ të thelluar për identifikimin e vendvarrimit të dyshuar të shtetasit Rait Bajram Alikaj.

Procesi u iniciua mbi bazën e kërkesës së familjarit dhe u shoqërua me verifikime arkivore dhe administrim dëshmish nga banorë të zonës.

Verifikimet në terren identifikuan territorin e njohur si “Varri i Bolenës” si zonë me interes për kërkime të mëtejshme. Në bashkëpunim me ICMP u realizua vlerësim teknik me metoda jo-invasive. Raporti ICMP-së rekomandon hartimin e një Strategjie të Kërkimit në Terren (GSS) për ngushtimin e zonës së kërkimit.

3. Shpal, Rrethi Mirditë (dy vendvarrime)

Në zbatim të Vendimeve nr. 374, datë 02.06.2023 dhe nr. 724, datë 27.12.2023, Autoriteti zhvilloi verifikime administrative të thelluara për identifikimin e vendvarrimeve të personave të vdekur ose të zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit politik në Burgun e Spaçit. Procesi përfshiu kërkime arkivore pranë AIDSSH dhe strukturave të Ministrisë së Brendshme, administrim dëshmish nga familjarë dhe ish-punonjës të sistemit penitenciar, verifikime

në terren në zonat Shpal, Spaç dhe analizë të praktikave administrative historike mbi procedurat e varrimit. Nga analiza rezultoi se:

- Një pjesë e personave janë varrosur pranë varrezave të Kishës së Shpalit;
- Organizatorët e Revoltës së Spaçit dyshohet të jenë varrosur në juglindje të varrezave të Shpalit;

Në bashkëpunim me ICMP u realizuan ekzaminime jo-invasive në terren. Raporti ICMP-se, rekomandon vijimin e fazave të mëtejshme të kërkimit përmes gjurmimeve dhe koordinimin me familjarët për saktësimin e identiteteve.

4. Varrezat e Rrmajit (Shkodër) dhe Vorfë (Malësi e Madhe)

Në zbatim të Vendimit nr. 535, datë 29.08.2023, Autoriteti zhvilloi verifikime administrative të thelluara në qarkun Shkodër për identifikimin e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist. Procesi u zhvillua mbi bazën e kërkesave të familjarëve, aplikimeve të Shoqatës së Ish-të Përndjekurve Politikë Shkodër dhe kërkesës së Arqipeshkvisë së Shkodrës për identifikimin e eshtrave të 28 klerikëve katolikë.

U krye vlerësimi teknik dhe inspektimi në terren në varrezat e Rrmajit, Shkodër. Pas procesimit të të dhënave të përfuara përmes pajisjes Total Station, rezultoi një probabilitet shumë i lartë për praninë e mbetjeve kockore të personave të zhdukur. Verifikimet rezultoi se një nga vendvarrimet me interes kryesor ndodhet pranë murit juglindor të Varrezave të Rrmajit.

Është vendosur tabela shenjzuese për ruajtjen e territorit deri në vijimin e kërkimeve të mëtejshme.

Raporti ICMP-se, identifikon anomali nëntokësore me interes mjeko-ligjor dhe rekomandon vijimin e kërkimeve përmes ndërhyrjeve përmes gërmimeve.

5. Shelegur (Mali i Gramozit), Bashkia Kolonjë

Në zbatim të Vendimit nr. 371, datë 30.05.2023, Autoriteti zhvilloi hetim administrativ për qartësimin e fatit dhe identifikimin e vendvarrimit të shtetasit: Dhimitraq Kono

Dokumentacioni arkivor konfirmon se shtetasi Dhimitraq Kono është vrarë në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit në janar 1963 dhe se trupi nuk iu dorëzua familjes. Verifikimet në terren identifikuan një vendvarrim të dyshuar në territorin “Sheshi i Zambaqëve”, rreth 900 metra nga vija kufitare me Greqinë.

Në bashkëpunim me ICMP u realizua ekzaminim jo-inviziv në terren. Raporti ICMP-se rekomandon vijimin e hetimeve përmes ndërhyrjeve me gërmim.

Konkluzion:

Bazuar në verifikimet administrative dhe ekzaminimet në terren të kryera nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), rezulton se ekzistojnë tregues të qartë për praninë e vendvarrimeve me interes në këto zona.

Në këtë kuadër, Autoriteti thekson nevojën për vijimin e veprimeve të mëtejshme përmes ndërhyr-

jeve nëpërmjet gërmimeve dhe kërkon mbështetjen dhe bashkëpunimin e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, si dhe të strukturave të specializuara mjeko-ligjore dhe ligjzbatuese. Angazhimi i koordinuar ndërinstucional është i domosdoshëm për avancimin e procesit të identifikimit, garantimin e standardeve profesionale dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj familjarëve të personave të zhdukur.

Në proces:

Në vijim të procesit të verifikimeve administrative për identifikimin e vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, janë aktualisht në proces vlerësimi paraprak disa vendndodhje të tjera me interes potencial mjeko-ligjor dhe historik. Konkretisht, janë duke u trajtuar rastet që lidhen me territorin e quajtur “Lumi i Terhanit”, Bashkia Pogradec; territorin pranë ish-Burgut të Vjetër në Kopluk, Bashkia Malësi e Madhe, fshati Panahor në Bashkinë Mallakastër; si dhe zonën Krastë, Bashkia Elbasan.

Tabela. 2 pasqyron punën e Drejtorisë referuar Vendimeve për fillimin e Verifikimeve Administrative nga Autoriteti. Janë marre 4 vendime lidhur me Verifikimin Administrativ në vitin 2025. Për periudhën krahasimore 2022-2025 janë marrë gjithsej 13 Vendime për fillimin e Verifikimeve Administrative.

Viti	Hetimet/Verifikimet Administrative
2025	4
2024	3
2023	3
2022	0
Total	10

Tabela 2.

Vendvarrimet e Identifikuara dhe të Dyshuara

Tabela. 3 Numri i vendvarrimeve të evidentuara gjatë periudhës 2022-2025. Evidentuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendvarrime të personave të zhdukur nga ish-regjimi komunist. Dy prej tyre janë të identifikuara me dokumente arkivore dhe dëshmi që në to janë varrosur trupat e të vrarëve dhe të vdekurve në burgje gjatë vuajtjes së dënimit:

1. Vendvarrimi pranë varrezave ngjitur me rrethimin e Kishës Katolike Shpal, Njësia Administrative Orosh, Bashkia Mirditë.
2. Vendvarrimi pranë varrezave të fshatit Shënavasil, Njësia administrative Lukovë, Bashkia Himarë.

Tabela 3.

Viti	Vendvarrimet e Identifikuara dhe të Dyshuara
2025	5
2024	6
2023	5
2022	0
Total	16

Intervista dhe dëshmi ndër vite

Tabela 4.

Viti	Intervista/Dëshmi për Personat e Zhdukur
2025	5
2024	5
2023	6
2022	1
Total	17

Të rëndësishme:

- Është rikonceptuar dhe aprovuar formulari i ri tip për “Kërkimin dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur” i disponueshëm për publikun në www.aidssh.al
- Është kryer reflektimi i shtigjeve të kalimit të kufirit dhe postave kufitare në rrethin e Shkodrës të identifikuara në MyGoogleMap duke mundësuar rritjen e vizibilitetit të punës së Autoritetit dhe përpjekjeve për përmbushjen e objektivave të ngarkuara nga ligji, *linku*: <https://www.google.com/maps/d/edit?hl=en&mid=1OJ1vyimtr3cNzFcPMvdNi-aUU6lhERhg&ll=42.067099573516515%2C20.809359416652633&z=8>
- Pjesëmarrje në nisma të rëndësishme të promovimit të transparencës dhe drejtësisë tranzicionale, në dokumentimin e krimeve të komunizmit, përrshirë mbështetjen e procesit të identifikimit dhe ri gjetjes së mbetjeve të viktimave që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit.
- Prezantimi i seksionit “Kujtesa e Personave të Zhdukur” në faqen zyrtare SPAC.al. gjate aktivitetit “Spaçi në kujtesën digjitale”. Qëllimi: rritjen e transparencës, ruajtjen e kujtesës kolektive dhe informimin e publikut mbi proceset e kërkimit, identifikimit dhe nderimit të tyre.
- Në bashkëpunim me ICMP-në, kryerja e aktiviteteve kërkimore me metoda jo invazive në 6 vendvarrime të dyshuara, në 2 prej tyre përdorur teknika gjeofizike si GPR dhe drone.
- Fillimi i procedurave për 4 hetime të reja administrative në Lezhë, Ballsh dhe Reparti 309
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, AIDSSH, në bashkëpunim me

Bashkinë Shkodër, Universitetin “Luigj Gurakuqi” dhe partnerë institucionale si BE, ICMP dhe OSBE, organizoi më 28 gusht 2025 simpoziumin “Kufiri i shpresës dhe i vdekjes 1944–1991 – Shkodra përballë të kaluarës”, gjatë të cilit u trajtuan politikat kufitare si instrument represioni, duke evidentuar përmes dokumenteve arkivore dhe dëshmime të 13 studiuesve dhe familjarëve të viktimave shndërrimin e kufirit (1944–1991) në një hapësirë dhune. Kryetarja e Kuvendit dhe përfaqësuesit e BE-së dhe OSBE-së theksuan nevojën për drejtësi tranzitore, gjetjen e trupave të të zhdukurve dhe forcimin e mekanizmave institucionale, duke e lidhur këtë proces me vendosjen e drejtësisë për viktimat. Universiteti u vlerësua për rolin e tij në kërkimin shkencor dhe edukimin e brezave, ndërsa u avancua më tej nisma për ngritjen e një memoriali në kujtim të viktimave. Ky aktivitet e afrooi më tej AIDSSH me komunitetin lokal, duke forcuar bashkëpunimin me familjarët dhe aktorët vendas në funksion të dokumentimit dhe gjetjes së fatit të personave të zhdukur.

- Intensifikimi i përpjekjeve të lobimit për miratimin e VKM-së që përcakton përgjegjësitë e secilit institucion dhe mundëson nisjen e procesit të gërmimeve dhe identifikimit është urgjent dhe i pazëvendësueshëm. Ministria e Brendshme, e cila duhet të luante një rol kyç, nuk e ka konsideruar si pjesë të detyrave të saj nismën për zgjidhjen e kësaj çështjeje, ndonëse Ligji 45/2015 e përcakton qartë rolin e saj. Në të njëjtën kohë, Ministria e Drejtësisë ka pranuar që nisma të jetë e përbashkët me Ministria e Brendshme. Si rezultat, procesi ka ngecur dhe qindra vendvarrime të dyshuara mbeten të paprekura, ndërsa prova të çmuara mund të humbasin përgjithmonë.

- Përfundimi i fazës së parë të Projekt-materialit për ndryshimet ligjore të ligjit organik 45/2015 i ndryshuar, si dhe një Relacion shpjegues që lidhet me procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur.

6.5 MBËSHTETJA SHKENCORE DHE EDUKIMI QYTETAR


Mbështetja shkencore për qëllime studimore e mediatike

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, në funksion të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse, vijoi punën për mbështetjen e kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar mbi veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit.

Përgjatë vitit 2025, Autoriteti ka realizuar si më poshtë:

- ✓ **154** kërkesa studimore trajtuar në 42 mbledhje të Autoritetit, nga të cilat **15** kërkesa nga media; kërkuar informacion për **305** persona dhe **83** ngjarje; **89** kërkues janë me shtetësi shqiptare dhe **13** të huaj.
- ✓ **47** studiues kanë konsultuar **163** herë në sallë dokumentacionin e legjitimuar dhe marrë vendimi në mbledhjet e Autoritetit në sajë të kërkesave përkatëse (e dhënë e gjeneruar bazuar regjistrin të mbajtur në drejtori për çdo konsultim në sallë).
- ✓ Është miratuar vënia në dispozicion të studiuesve e **1092** dosjeve me një total prej **135,024** faqe, ndër të cilat janë përpunuar dhe anonimizuar **23, 677** faqe.

Periudha/indiktorët	Janar-Prill 2025	Maj – Gusht 2025	Shtator –Dhjetor 2025	Vjetori 2025
Numër mbledhjesh të Autoritetit	16	12	14	42
Kërkesa gjithsej	40	56	58	154
Numër personash, objekte, ngjarje për të cilat është kërkuar informacion	123	136	129	388
Relacione	73	68	115	256
Vendime	36	16	56	108
Kërkesa pa të dhëna	1	2	2	5
Kërkesa të refuzuara	-	-	1	1
Faqe total vënë në dispozicion	58,386	20,845	55,793	135,024





Krahasimi (2017-2025)

Nga një strukturë fillestare me vetëm 20 kërkesa në vitin 2017, Autoriteti ka arritur në vitin 2025 një nivel të qëndrueshëm dhe të konsoliduar të kërkimit shkencor dhe aksesit në arkiva.

Numri i kërkesave studimore është rritur gradualisht, duke arritur në 156 në vitin 2025, ndërsa volumi i dokumenteve të trajtuara ka njohur një rritje shumë më të theksuar, nga 29,556 faqe në vitin 2025 në mbi 135 mijë faqe.

Një moment kulmor shënohet në vitin 2023, me mbi 1300 dosje të vëna në dispozicion, duke reflektuar një zgjerim të ndjeshëm të kapaciteteve dhe të aksesit, si rezultat i përmirësimit të kuadrit ligjor në fund të vitit 2022. Në vitet pasuese, ky nivel është stabilizuar, duke ruajtur një volum të qëndrueshëm.

Në vijim të ndryshimeve ligjore, si dhe për t'u ardhur në ndihmë medias dhe kërkuesve, Autoriteti në bashkëpunim me Prezencës së OSBE-së në Tiranë, përmes një eksperti ndërkombëtar, hartoi dhe publikoi Udhëzuesin për gazetarë dhe kërkues, i cili synon t'i ndihmojë ata në përdorimin më efektiv të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.



Edukim qytetar dhe projekte

Gjatë vitit 2025, është vijuar me zbatimin e nismave kyçe duke u fokusuar në edukimin qytetar dhe kërkimin shkencor mbi të shkuarën komuniste. Aktivitetet e ndërmarra synojnë të ndërgjegjësojnë shoqërinë mbi pasojat e diktaturës dhe të ofrojnë qasje të hapur në dokumentet historike, duke kontribuar në ndërtimin e një kulture të kujtesës.

Gjatë vitit 2025 fokusi është vendosur në nismat kryesore, si:

Platforma digjitale “Mësojmë nga e Kaluara”

Në vijim të misionit për edukimin qytetar, Autoriteti në bashkëpunim¹ me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (sot Ministria e Arsimit), ka vijuar zhvillimin e platformës “Mësojmë nga e Kaluara – Burime Arsimore të Hapura 1944–1991”, e cila është një platformë digjitale e dedikuar, me burime autentike në shërbim të mësuesve, prindërve, nxënësve, studentëve, studiuesve, autorëve të teksteve,

1 Marrëveshja e bashkëpunimit e datës 18.03.2021

botuesve, etj., dhe që do të përfshijë institucione të arsimit parauniversitar, studentë e mësimdhënës të historisë, shoqata dhe grupe të interesit, studiues e të interesuar, duke e angazhuar shoqërinë me bazë të gjerë, në marrjen dhe dhënien e informacionit që nxit reflektimin mbi totalitarizmin dhe me të cilin shoqëria merr përgjegjësitë e saj. foto, filmime dhe botime që ndihmojnë në kuptimin e historisë në periudhën 1944 -1991. Platforma do të përfshijë elementë multimedialë si video infografika dhe kuize interaktive, për të ndihmuar përdoruesit të kuptojnë kontekstin historik dhe rëndësinë e periudhës komuniste shqiptare. Forumet e diskutimit dhe webinarët e drejtpërdrejtë do të lehtësojnë komunikimin dhe të kuptuarit e informacionit, duke ofruar një mënyrë më efikase për mësuesit. Aksesi në burime të kuruara dhe studime do të rrisë njohuritë dhe do të nxisë mendimin kritik për këtë periudhë të historisë shqiptare.

Deri në publikimin e platformës, Autoriteti ka organizuar aktivitete dhe prodhuar materiale për arsimin parauniversitar, të cilat janë produkte të platformës.

Veprimtari edukative

- Klubi i Librit

Gjatë vitit 2025, klubet e librit “Mësojmë nga e Kaluara” u zhvilluan në qytetet Tiranë, Korçë, Sarandë dhe Konispol, duke u shndërruar në hapësira reflektimi dhe dialogu ndërmjet brezave. Diskutimet u përqendruan në vepra të rëndësishme memuaristike dhe historike.

- Turi i Leximit dhe Informimit

Në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë, u zhvilluan 11 takime në disa qytete të vendit, duke përfshirë Tiranën, Elbasanin, Shkodrën, Durrësin, Vlorën dhe të tjera.

Në këto aktivitete morën pjesë 302 nxënës dhe 23 mësues nga 10 shkolla, si dhe pjesëmarrës në aktivitete të hapura në qendra kulturore. Programi u ndërtua mbi botimet e Autoritetit si “Dielli lind në Spaç”, “Spaç – historia e një revolte” dhe “Kufij të thyer”.

Temat e trajtuara përfshinë historinë e periudhës 1944–1991, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe dëshmitë e të mbijetuarve. Një rezultat i rëndësishëm i këtij programi ishte prodhimi i rreth 80 materialeve krijuese nga nxënësit, si dhe ndikimi i projektuar në rreth 2499 nxënës të tjerë.

- Klubi i Filmit 2025

Në bashkëpunim me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, u zhvilluan tre aktivitete në Tiranë dhe Lezhë, me pjesëmarrjen e 265 personave.

Në fokus ishin filmat e Kinostudios “Shqipëria e Re”, si “Toka jonë” dhe “Vitet e para”, të cilët u analizuan në mënyrë kritike për të evidentuar kontrastin midis narrativës propagandistike dhe realitetit historik të kohës.

Kjo nismë dëshmoi potencialin e kinemasë si mjet edukimi dhe reflektimi mbi mekanizmat e propagandës.

- Vizita në AIDSSH

Janë zhvilluar 4 vizita në AIDSSH: Shkolla 9-vjeçare jo publike “Albanët”, Shkolla 9- vjeçare “Gustav Majer”, Studentë të Masterit të Mësuesisë në Histori, Kolegji Universitar “Qirjazi”.

Dokumentimi i kujtesës dhe prodhimet audio-vizuale

- Dëshmi të Gjalla

Gjatë vitit 2025 janë mbledhur dhe zbardhur 36 dëshmi gojore, duke e çuar në 165 numrin total të dëshmive të mbledhura që nga viti 2018.

Në këtë kuadër, u realizua dokumentari “Ana tjetër e Valiasit”, i cili u prezantua më 23 gusht dhe u transmetua në disa media kombëtare. Dokumentari sjell në vëmendje kushtet çnjerëzore të kampit të Valiasit dhe përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në dokumentimin e krimeve të regjimit.

Paralelisht, Autoriteti realizoi botimin e tre periodikëve, albumit të veprimtarive, raportit vjetor 2024, si dhe dizenjimin e materialeve informuese dhe publikimin e vendimeve të institucionit.

Aktivitetet publike dhe kalendarit i kujtesës

Për qëllime të edukimit qytetar, në bazë të kalendarit të kujtesës dhe në kuadër të informimit e ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe edukimit për demokraci janë organizuar 36 aktivitete, ndwr tw

cilat spikasin:

- Përkujtimi i Revoltës së Spaçit dhe lançimi i platformës spac.al;
- Aktivitetet në Ditën Ndërkombëtare të Viktimave të Totalitarizmit;
- Simpoziumi ndërkombëtar në Shkodër mbi personat e zhdukur;
- Përkujtimi i 100-vjetorit të Martin Camajt;
- Pjesëmarrja në Festivalin e Filmit për të Drejtat e Njeriut.

Partneritetet me universitetet dhe institucionet akademike

Gjatë vitit 2025, Autoriteti ka forcuar ndjeshëm bashkëpunimin me institucionet akademike, duke e konsideruar këtë dimension si një komponent strategjik për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar.

Në këtë kuadër janë zhvilluar 9 tryeza pune për nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institute kërkimore, përfshirë Universitetin e Shkodrës dhe Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Gjithashtu, janë organizuar leksione të hapura pranë Autoritetit, Universitetit të Tiranës dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës, me një pjesëmarrje prej 191 studentësh dhe pedagogësh, si dhe janë zhvilluar dialogë lokalë në disa qytete

mbi temat e kujtesës historike, figurave të pastra dhe personave të zhdukur.

Komunikimi publik dhe angazhimi i target-grupeve

Paralelisht, Autoriteti ka zgjeruar komunikimin publik, përmes faqes zyrtare, web-faqeve tw veçanta tw vendeve tw kujtesws dhe rrjeteve sociale, duke publikuar dhjetëra materiale informuese dhe audiovizuale, si dhe duke arritur një ndërveprim të lartë me publikun.

- Faqet web

Gjatë vitit 2025:

- ✓ www.aidssh.al popullim me materiale: 6 buletinë, album AIDSSH, Raport vjetor, prezantime, video, fotografi, dokumentarë;
- ✓ www.spac.al është pasuaruar me 250 profile dhe të dhëna të tjera.
- ✓ Ka filluar puna përgatitore për ndërtimin e faqes së Kampit të Tepelenës.
- ✓

- Media sociale

Gjatë vitit 2025 është punuar për menaxhimin e 5 rrjeteve sociale

- ✓ Përditësimi i Klubit të Librit “Mësojmë nga e Kaluara” (facebook, instagram)

Hapja e faqeve të reja për:

- ✓ Burgun e Spaçit (facebook, instagram)
- ✓ Kampin e Tepelenës (facebook, instagram)
- ✓

Përfshirja dhe angazhimi i target-grupeve të synuara në gjuhën e shifrave

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 36 aktivitete dhe 2 ekspozita, njëra shoqëruese e Klubit të Filmit, zhvilluar në holl dhe në mjediset e jashtme në AQSHF si dhe te Vila 31, me pjesëmarrjen e target-grupeve të ndryshme me një total pjesëmarrjeje prej 1196 persona.

Sipas target-grupeve me fokus edukimin, gjatë vitit 2025 kanë marrë pjesë 459 nxënës, 153 studentë, 37 mësues dhe 9 pedagogë. Sipas projektimit të bërë nga mësuesit që morën pjesë në Turin e Leximit dhe Informimit, informacioni i marrë gjatë takimeve do të përcillet në 2499 nxënës.

Aktiviteti	Sasia / takime	Pjesëmarrja	Nxënës	Mësues	Studentë	Pedagogë
Klubi i Librit	4	100	12	4	25	4
Tur i Leximit & Informimit	11	302	302 (2499 nxënës të projektuar)	23	-	-
Klubi i Filmit	3	265	31	5	102	4
Arkiv i hapur	4	114	114	6	26	1
Ekspozita shoqëruese për klubin e filmit	2	e hapur për publikun				
Aktivitete të tjera: Leksion i hapur & dosje e hapur, Spaç	5	203				
Aktivitete në data kujtese	7	212				
TOTAL	36	1196	459	37	153	9

6.6 SIGURIA DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK

Sektori i Teknologjisë së Informacionit

Sektori i Teknologjisë së Informacionit gjatë periudhës raportuese Janar - Dhjetor 2025, ka garantuar funksionimin e sistemeve dhe pajisjeve të infrastrukturës qendrore të dhomës së serverave.

Në funksion të përmirësimit cilësor të punës dhe përdorimit të teknologjive të reja, janë instaluar programe në kompjuterat e stafit përdorues, sipas kërkesave dhe proceseve të punës. Është ndërhyrë për probleme në printime, skanime, konvertime dokumentesh, word-pdf / jpg-word / jpg-pdf etj. Gjithashtu, në rastet e nevojshme është kryer

instalimi i programit të gjuhës shqipe, mirëmbajtja e sistemit audio në sallën e mbledhjeve, hapja e adresave zyrtare (AKSHI), suport për përditësimin e fjalëkalimeve të paktën njëherë në tre muaj sipas rregullores së AKSHI-t, “Për përdorimin e postës elektronike në Administratën Publike” etj.

Mesatarisht, ky sektor ka asistuar për 20–30 raste problematikash në ditë, nga më të thjeshtat deri tek suportu dhe ndërhyrja e specializuar.

Sektori i Teknologjisë së Informacionit gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 ka mundësuar përmirësime e riorganizime të faqes zyrtare të Autoritetit: www.aidssh.al, ka siguruar mbarëvajtjen nga ana teknike dhe në kuadër të sigurisë, si dhe ka vijuar me **përditësimin dhe editimin e rubrikave**, dhe përditësimin me materiale,

informacione, dokumente, njoftime, njoftime për shtyp, konferenca shkencore, vendimet e Autoritetit, deklasifikimet, publikimet e vendeve të lira të punës etj. , sipas kërkesave të strukturave **përkatese, në funksion të transparencës dhe misionit të Autoritetit. Duke qenë se përmasat e Institucionit kanë ndryshuar (janë rritur) dhe qasja me publikun është më e madhe, sektori i TI-së në bashkëpunim me drejtorinë e tjera në Autoritet, ka kryer ndryshimet e nevojshme në paraqitjen e faqes web dhe shtim menush e nën-menush.**

Media Sociale

Hapur dhe menaxhohen accounte/llogari për media sociale, konkretisht facebook dhe instagram:

- mediateka_aidssh
- spac.al
- Kampi i Tepelenës

- Kërkojmë të Zhdukurit - Autoriteti i Dosjeve të ish-Sigurimit
- Aidssh - Klubi i librit “Mësojmë mbi të kaluarën”

Krijimi dhe publikimi online i webfaqes spac.al.

Në dhjetor të vitit 2024 u publikua online webfaqja e populluar me përmbajtje www.spac.al

Ka vijuar popullimi me përmbajtje nga strukturat përgjegjëse në Autoritet, sipas kërkesave të anëtarëve të grupit të punës së ngritur për mbarëvajtjen e webfaqes spac.al . Ka vijuar mirëmbajtja nga ana teknike e webfaqes, si dhe përditësime në kuadër të sigurisë, sipas kërkesave të AKSHI-t. Është realizuar shërbimi i përkthimit të përmbajtjes në gjuhën angleze dhe është publikuar përkatesisht në seksionin e detikuar të gjuhës angleze.

Të dhëna statistikore mbi numrin e publikimeve online

Publikime	Janar - Dhjetor
Faqja zyrtare aidssh.al	7 Bibliografi të informacionit të deklasifikuar sipas vendimeve në Autoritet, 36 Njoftime procedurash punësimi, 37 njoftime publike për aktivitete të ndryshme, 5 Buletine për veprimtarinë e Autoritetit
Spac.al	Publikuar gjithë përmbajtja aktuale e faqes, versioni shqip dhe anglisht.
Klubi i Librit	1 publikim libër
ISSUU	5 publikime

Ka filluar procedura për akreditimin e 3 (tre) kompjuterëve të tempestuar dhe 3 (printerëve) të tempestuar nga AKSIK sipas standarteve të sygjeruara nga ky i fundit dhe mbështetur në aktet ligjore në fuqi.

Sistemi i arkivës digjitale dhe menaxhimit të kërkesave

Është punuar sistematikisht për vënien në punë të sistemit të arkivës digjitale dhe menaxhimit të kërkesave.

- Është përgatitur dhe miratuar Udhëzuesi *“Për organizimin dhe funksionimin e sistemit informatik të arkivës digjitale dhe menaxhimit të kërkesave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të shtetit”*, si dhe manuali teknik i përdorimit të sistemit.
- Ka vijuar puna për regjistrimin në sistem të praktikave të mbyllura të vitit 2024 dhe praktikave të administruara gjatë vitit 2025.
- Gjatë vitit 2025 janë regjistruar në sistem gjithsej 772 kërkesa për informim, nga të cilat 505 kërkesa janë të trajtuara/mbyllura dhe 267 janë në proces trajtimi. Më poshtë të dhënat statistikore sipas tipologjive të kërkesave/formularëve të aplikimit.

Gjatë periudhës raportuese janë shfaqur probleme teknike të cilat i kemi adresuar tek operatori i kontraktuar për mirëmbajtjen e Sistemit të Arkivës Digjitale dhe Menaxhimit të Kërkesave (SADMK), nëpërmjet Kontratës me nr. 1014/13, datë

28.10.2025, me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të arkivit digjital dhe menaxhimit të kërkesave të AIDSSH”, dhe aktualisht jemi në fazën e ndërprerjes së kontratës për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorit të kontraktuar.

Sistemi e-Conference dhe e-Studim

Është kryer mirëmbajtja, mbarëvajtja dhe asistenca teknike gjatë përdorimit:

- Sistemi **e-Conference**, i vendosur në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit i përbërë nga 6 terminale paperless, 1 kompjuter kontrolli dhe rack-u ku bëjnë pjesë të gjithë pajisjet dhe aksesorët e tjerë mbështetës. Është garantuar mbarëvajtja teknike e sistemit, krijimi i sesioneve sipas agjendës së rendit të ditës për çdo mbledhje, sigurimi i regjistrimit të mbledhjeve, mbajtja e kopjeve backup të audio regjistrimeve në pajisjet ruajtëse të infrastrukturës qendrore TIK në Autoritet, sipas detyrave të përcaktuara në urdhrin Nr. 47, datë 24.02.2025;
- Në sistemin **e-Studim**, të vendosur në bibliotekën “Musine Kokalari”, janë instaluar 10 kompjuter të tipit Thin Client dhe 1 kompjuter i tipit Workstation, të konfiguruar në një rrjet të mbyllur (pa qasje në internet dhe në rrjetin e brendshëm të Autoritetit), ku studiuesit qasen në fonde arkivore bazuar në kërkesat përkatëse, të legjitimuara dhe miratuara në Autoritet. Është garantuar

mbarëvajtja teknike dhe asistenca sipas de-tyrave të përcaktuara në urdhrin nr.48 datë 24.02.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe asistencën gjatë përdorimit të sistemit e-studim pranë Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;

- ❖ Është përgatitur dhe dërguar pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, praktika fillestare e akreditimit për 3 (tre) kompjutera dhe 3 (tre) pajisje periferike MFP, konform parashikimeve sipas VKM Nr. 792, datë 28.12.2023 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit (SKI)”.
- Në zbatim të ligjit nr. 25/2024 “ Për sigurinë kibernetike” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 06.11.2024 për miratimin e Metodologjisë “Për identifikimin e Operatorëve të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit” AKSK ka vlerësuar **klasifikimin e AIDSSH si Operator i Infrastukturës Kritike të Informacionit**. Në këtë kuadër STI ka marrë pjesë në të gjitha trajnimet e zhvilluara nga ky autoritet në kuadër të Qeverisjes së mirë kibernetike dhe implementimit të masave të sigurisë kibernetike, duke u fokusuar kryesisht por pa u kufizuar në:

Sektori i Digjitalizimit dhe Fotokopjes

Gjatë vitit 2025, Sektori i Digjitalizimit dhe Fotokopjes ka vijuar procesin e digjitalizimit, administrimit dhe vënies në dispozicion të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për strukturat e institucionit, studiuesit, mediat dhe individët, në përputhje me kërkesat e drejtorive përgjegjëse për informimin.

Procesi ka përfshirë përgatitjen e materialeve arkivore, verifikimin e deklasifikimit, skanimin sipas standardeve teknike, kontrollin e cilësisë dhe indeksimin e dokumenteve në arkivën digjitale, duke garantuar ruajtjen e integritetit të tyre dhe lehtësimin e kërkimit në dokumente.

Gjatë vitit 2025 janë digjitalizuar 122 dosje fizike, janë prodhuar 16,229 imazhe dhe 2,715 dublikata fotokopje, si dhe janë administruar 204 CD, ndërsa përmes operatorit ekonomik të kontraktuar janë realizuar rreth 205,000 imazhe digjitale. Krahasuar me vitin 2024, procesi ka shënuar përmirësim në cilësinë e skanimit dhe në efikasitetin e përpunimit të kërkesave, ndërsa sektori ka ndërmarrë masa për optimizimin e procedurave të punës, standardizimin e formateve digjitale dhe trajnimin e stafit, pavarësisht sfidave që lidhen me gjendjen fizike të një pjese të dokumenteve, volumin e kërkesave dhe hapësirat e kufizuara të punës.

Të dhëna statistikore për vitet 2024 dhe 2025 për dokumentet e digjitalizuara nga Sektori i Digjitalizimit dhe Fotokopjes dhe Operatori Ekonomik i kontraktuar.

Sektori i Sigurisë Fizike dhe Digjitale

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, Sektori i Sigurisë Fizike dhe Digjitale, ka monitoruar sigurinë fizike, zbatimin e urdhrave të hartuar për vendosjen e parametrave të kërkuar të sigurisë për informacionin e klasifikuar.

Viti	Dosje fizike	CD	SDF/ Imazhe / dublikata fotokopje	Operatori Ekonomik /Do- kumente imazhe
2024	646		46,772 imazhe 887 dublikata	1,420,096 imazhe
2025	122	204	16,229 imazhe/ 2,715 dublikata	205,000 imazhe

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë masa për:

- optimizimin e procedurave të digjitalizimit dhe organizimit të punës;
- përmirësimin e cilësisë së dokumenteve të skanuara përmes korrigjimit të kontrastit dhe orientimit të faqeve;
- standardizimin e formateve digjitale dhe të mënyrës së indeksimit;
- zhvillimin dhe trajnimin periodik të stafit për teknikat bashkëkohore të digjitalizimit dhe ruajtjes arkivore.

Në zbatim të detyrave të sektorit, që lidhen fillimisht me lehtësimin e procedurave të hyrjedaljeve të vizitorëve, aplikantëve dhe personave të ftuar në Autoritet, janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorinë për Marrëdhëniet me Jashtë, si dhe me Batalionin e Sigurisë (Repartin Ushtarak Nr. 6630).

Gjatë vitit 2025 kemi aplikuar për Certifikatë të Sigurimit të Personelit për 7 punonjës të rinj dhe për ripajisje me CSP për 13 (trembëdhjetë) punonjës, 4 aplikime për ndryshim niveli CSP, 1 aplikim për konfirmim vlefshmërie CSP dhe 1 aplikim për korrigjim rekordesh CSP.

Të dhëna statistikore sipas 4 mujorëve të Vitit 2025.

Periudha/indiktorët	Vjetori 2024	Vjetori 2025
Numri i vizitorëve vendas	1216	1887
Numri i vizitorëve të huaj	83	70
Aplikim për pajisje CSP	16	7
Aplikim për ripajisje CSP	7	13
Aplikim për ndryshim niveli CSP	-	4
Aplikim për konfirmim vlefshmërie CSP	-	1
Aplikim korigjim rekordesh CSP	-	1
Korespondenca me Batalionin e Mbështetjes MM	83	77
Korespondenca me Shtabin e Përgjithshëm MM	42	39
Korespondenca me AKSIK	18	33

Një aspekt tjetër i punës sektorit, lidhet me **rritjen e nivelit të sigurisë** gjatë eventeve të mbajtura në ambientet e Autoritetit.

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, Sektori i Sigurisë Fizike dhe Digjitale ka realizuar detyrat e tij në funksion të garantimit të sigurisë fizike të godinës, kontrollit të aksesit dhe zbatimit të legjislacionit për informacionin e klasifikuar në Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Aktiviteti ka përfshirë hapjen dhe mbylljen e institucionit, kontrollin e përditshëm të sigurisë së godinës dhe funksionimit

të sistemeve elektronike të akses-kontrollit, kamerave të sigurisë dhe sistemit kundër zjarrit, si dhe monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë në ambientet e institucionit. Gjithashtu janë kryer procedura për sigurinë e personelit, përfshirë aplikime për certifikata sigurie, zhvillimin e instruktazheve dhe brifimeve periodike të sigurisë për stafin, si dhe proceset e deprifimit për punonjësit që kanë përfunduar marrëdhëniet e punës. Sektori ka administruar procesin e pajisjes së punonjësve me karta aksesit dhe dokumente hyrje-dalje në Garnizonin “Skënderbej”, si dhe ka siguruar shoqërimin e vizitorëve vendas dhe të

huaj në ambientet e institucionit dhe arkivit. Në vijim të përmbushjes së detyrave institucionale, sektori ka kontribuar në përgatitjen e disa akteve administrative dhe vendimeve në fushën e sigurisë dhe informacionit të klasifikuar, si dhe ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit.

6.7 SHËRBIMET E BRENDSHME DHE FINANCËS

Prokurimet dhe asistenca ligjore

a) Prokurimet

Gjatë këtij viti janë realizuar në total 40 zëra prokurimi nga të cilat:

- 20 zëra blerje me vlerë të vogël;
- 2 procedura të hapura të thjeshtuara (*Blerje e instalim të pajisjeve të rrjetit, serverave, licenca për backup dhe për sigurinë kibernetike dhe Platforma Mediateka*);
 - 2 minikontratat e fundit në kuadër të Marrëveshjeve Kuadër të lidhura në vitin 2023 për *“Skanimin e dokumenteve arkivore” dhe “Dizajnin, redaktimin gjuhësor dhe printimin e botimeve të Autoritetit, si periodikë, përmbledhje shkencore, broshura, rregullore, raporte, albume fotografikë, postera, fletëpalosje, kalendarë”*;
- 16 zëra të tjerë blerje me vlerë nën 100,000 lekë.

Në kuadër të investimeve janë kryer me sukses

procedurat e prokurimit për:

- (i) Blerje e instalim të pajisjeve të rrjetit, serverave, licenca për backup dhe për sigurinë kibernetike;
- (ii) Rinovimi/Rimodelimi dhe mirëmbajtje e web zyrtar;
- (iii) Blerje paisje informatike;
- (iv) Blerje pajisje zyre dhe të tjera.

Ndërkohë është kryer procedura dhe është konkluduar me fituesin e procedurës për “Marrëveshjen Kuadër të Skanimit të dokumentacionit arkivor me afat 24 muaj”, e cila është procedurë mbi kufirin e lartë monetar sipas përcaktimit në VKM.

Theksojmë se kjo procedurë prokurimi ka zgjatur në kohë për faktin se afatet ligjore për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar janë më të gjata në krahasim me procedurat e tjera (*në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë, afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, gjithashtu edhe afati i vlerësimit të ofertave zgjat 20 ditë, afatet e ankimimit janë 10 ditë etj*).

Ndër të tjera, një tjetër arsye ka qënë edhe ankimi në KPP i njërit prej operatorëve ekonomik të skualifikuar, e në këto kushte Autoriteti Kontraktor ka pezulluar procedurën e prokurimit deri në pritje të vendimit të KPP, e cila deri në fund të vitit 2025 nuk doli ende me një vendim për këtë ankesë të depozituar nga OE.

Fonde të prokuruar. Në total janë prokuruar (fondi limit) 19,110 mln lekë. Në përfundim të

procedurave, fondet e kontraktuara në total kapin shumën prej 15,2 mln lekë nga të cilat:

a) Marrëveshjet e bashkëpunimit për vitin 2025

- 6 marrëveshje bashkëpunimi të miratuara në mbledhjet e organit kolegjal dhe të nënshkruara midis AIDSSH dhe Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF), Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Institutin Albanologjik të Prishtinës, Institutin e Historisë “Ali Hadri”, fondacionin “kujo.al”, fondacionit “Konrad Adenauer”;

- 1 marrëveshje bashkëpunimi e miratuar në mbledhjen e organit kolegjal të Autoritetit midis AIDSSH dhe Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, e cila është në fazën e nënshkrimit.

b) Kallëzimet penale dhe proceset gjyqësore, ku institucioni ka qenë palë në proces

Më poshtë renditen të detajuara çështjet gjyqësore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në proceset gjyqësore, ku institucioni ka qenë palë në proces për vitin 2025.

Nr.	Paditës	Faza e procesit	Komente
1	Q.Q.	Çështje gjyqësore në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	<p>Paditësi Q.Q., i përfaqësuar dhe me av. O.S., ka kërkuar shfuqizimin e pjeshëm të vendimeve të Autoritetit nr. 648, datë 02.11.2023 dhe nr. 719, dt. 15.12.2023, për sa i përket pjesës me përmbajtjen: <i>“Shtetasi Q.Q nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtor apo i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, dhe as i survejuar, por figuron në një çështje gjyqësore (penale) me detyrën (cilësinë) e prokurorit në rrethin e Tiranës në vitin 1987 për akuzën që përfshin ekzekutimin me vdekje, tradhti ndaj atdheut. Kjo është pafajësuar dhe si e tillë konsiderohet vepër penale politike, vendim i cili iu dërgua kërkuesit”</i>. Në seancën e datës 23.12.2024, kjo çështje u bashkua me një çështje tjetër me po të njëjtat palë ndërgjyqëse, por me objekte të ndryshme (objekti i çështjes tjetër ishte: <i>Shfuqizimi pjesërisht i aktit administrativ, vendimit nr. 7, datë 12.09.2023, deklarifikuar me vendim datë 03.01.2024, pika 3, e dispozitivit të vendimit të Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me përmbajtje –“Figuron në një çështje gjyqësore (penale) të arshivuar në Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të administruar nga Autoriteti, në detyrën (cilësinë) e Prokurorit në rrethin e Tiranës, në vitin 1987, për akuzën, “Tradhti ndaj atdheut”, vepër penale e parashikuar nga neni 47/1 i Kodit Penal, në kreun, ‘Krime kundër shtetit’, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale të përkufizuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, ‘Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë’, të ndryshuar dhe hyjnë në fushën e veprimit të ligjit 45/2015, ‘Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë’”).</i></p> <p>Në seancën gjyqësore të datës 25.02.2025, gjykata vendosi që të pranojë pretendimet e palës paditëse, duke vendosur kështu pra shfuqizimin e pjesëve të kërkuara të vendimeve. Është dërguar ankimi në gjykatën e apelit administrativ.</p>

2	E.P.	<p>Çështje civile në proces në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Civile</p>	<p>Padi e ngritur prej shtetasit E.P., i përfaqësuar dhe me av. B.A., me objekt:</p> <p><i>“1. Detyrimin e palës së paditur të më paguaj 2 (dy) paga bashkë me sigurimet shoqërore e shëndetësore nga puna e kryer për periudhën (janar-shkurt 2024) sipas nenit 116 të Kodit të Punës.</i></p> <p><i>2. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën e 1 (një) page mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, parashikuar nga neni 144 i Kodit të Punës.</i></p> <p><i>3. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën e 2 (dy) pagave mujore për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, sipas nenit 144 i Kodit të Punës.</i></p> <p><i>4. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën e 12 (dymbëdhjetë) pagave mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkak të justifikuar të marrëdhënies së punës, sipas nenit 155 të Kodit të Punës.</i></p> <p><i>5. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën 21 (njëzet e një) ditë të lejes vjetore të pa konsumuar, që buron nga kontrata individuale e punës, sipas nenit 94 të Kodit të Punës.</i></p> <p><i>6. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me 1 (një) pagë mujore të lejes vjetore të pa konsumuar që buron nga marrëdhëniet e punës të cilat kanë hyrë në heshtje me afat të pa caktuar.</i></p> <p><i>7. Detyrimin e palës së paditur të paguaj shpenzimet gjyqësore, noteriale dhe të avokatisë.”</i></p> <p>Është dhënë vendimi më datë 15.04.2025, në të cilin pranohej pjesërisht kërkesa e palës paditëse, duke iu dhënë vetëm ditët e pushimit të të pamarrë në vitin 2023. Në pritje të komunikimit të vendimit të zbardhur për të vijuar më tej me ankimin në Gjykatën e Apelit.</p>
---	------	--	---

3	E.M.	Çështje gjyqësore në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	<p>Padi e ngritur prej shtetasit E.M., me objekt:</p> <p><i>“Shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ, vendimit nr. 175, datë 24.03.2020, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.</i></p> <p><i>Vërtetimin e faktit juridik të mos bashkëpunimit tim me ish-Sigurimin e Shtetit”.</i></p> <p>Është zhvilluar një seancë përgatitore më datë 05.11.2025. Në të u vendos që të zhvillohet seanca gjyqësore (për shqyrtimin dhe relatimin e çështjes) më datë 04.02.2026.</p>
---	------	--	---

Financa - Të ardhurat dhe shpenzimet e Autoritetit

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për vitin 2025 administroi dhe menaxhoi fonde nga disa burime financimi, si më poshtë:

1. Fonde buxhetore të akorduara bazuar në ligjin 115/2024 për AIDSSH në shumën prej 168,200,000 lekë.
2. Financim nga ICMP në shumën prej **2,070,579 lekë**
3. Të ardhurat dytësore, të cilat realizohen në zbatim të VKM nr. 93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”

- Fondet buxhetore

Me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit iu miratua numri i përgjithshëm prej 73 punonjësish dhe mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr. 113/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 95/2016 për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, ka ndryshuar dhe struktura e Autoritetit.

Për vitin 2025 me ligjin e buxhetit fondet e akorduara për AIDSSH janë 168,200,000 lekë.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025, janë shpenzuar 159,480,290 lekë duke arritur në një realizim të buxhetit në masën 96 % për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”.

- **Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore**

Ky zë shpenzimesh është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën 115,274,387 lekë për paga si dhe 18,808,948 lekë për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që përbëjnë në total rreth 99 % e fondit të planifikuar vjetor. Shpenzimet për paga janë kryer për punonjësit faktik në organikë dhe për punonjësit me kontratë. Për vitin 2025, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme të miratuar me vendimin 19 datë 09.01.2025 është 14 punonjës. Aktualisht janë 10 punonjës me kontratë të cilët janë paguar për punën e kryer (6 orë) duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore.

- **Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zeri 602)**

Për 12-mujorin 2025 është realizuar në vlerën 17,854,650 lekë nga 23,260,000 që është plani. Në këtë zë përfshihen fondi për shpenzime operative në vlerën 22,700,000 lekë dhe 560,000 lekë janë transferata të individët për pagesën e telefonisë celulare dhe pagesa nga fondi i veçantë.

Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 77% e planit total vjetor të shpenzimeve operative. dhe është kryesisht rezultat i fondeve të kursyera nga prokurimi.

- **Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)**

Buxheti i akorduar në këtë zë shpenzimesh për vitin buxhetor 2025 ishte 10,000,000 lekë. Në zbatim të aktit normativ nr. 11 datë 19.12.2025 fondi për investime u pakësua me 1,800,000. Për vitin 2025 realizimi faktik i shpenzimeve kapitale është 100% ndërsa ai financiar në shumën prej **7,542,188 lekë** e cila përbën një realizim në masën prej 92% . Kjo diferencë është rezultat i kursimit të fondeve si rezultat i prokurimeve. Investimet më kryesore të realizuara në vitin 2025 konsistojnë në “Ndertimi i Mediatekës” si dhe te “blerja e pajisjeve informatike back up etj” e cila mundëson një infrastrukturë të konsoliduar IT. Jo më pak i rëndësishëm është edhe rimodelimi i ëebit zyrtar i cili e bën më interaktiv ëebin zyrtar ku mund të gjejnë cdo informacion të rëndësishëm dhe ku mund të informojnë gjithahstu për të shkuarën komuniste.

- **Të ardhurave dytësore**

Këto të ardhura realizohen në zbatim të VKM nr.93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

Për priudhen Janar- Dhjetor 2025 janë arkëtuar në total 253,145 lekë, nga të cilat:

1. Nga 28 kërkesat studimore janë arkëtuar 120,100 lekë
2. Nga 47 kërkesat individuale janë arkëtuar 132,355 lekë.
3. Nga një kërkesë studentore është arkëtuar vlera 690 lekë

Të ardhurat e krijuara si më sipër derdhen totalisht në buxhetin e shtetit në kërkesë të vendimit të sipërcituar.

- Granti i financuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)

Nga granti i financuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin “Mbështëjtja e drejtësisë tranzitore dhe trajtimi i të shkuarës në Shqipëri” është arkëtuar vlera **2,070,579 lekë**.

Kjo vlerë mbulon shpenzimet për pagesën e pagës dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të koordinatorit të projektit.


Për periudhën raportuese janë shpenzuar në total 1,788,000 lekë, në zërin shpenzime për paga në llogarinë 600 (të ardhura jashtë limitit).

Organizimi i brendshëm i institucionit - struktura dhe organika e Autoritetit

Struktura dhe organika e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është

miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, nr. 95/2016, *“Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*, i ndryshuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 26/2022, datë 17.3.2022, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit””*, ndryshuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.19/2023, datë 16.3.2023, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit””*, u ndryshua struktura dhe organika e AIDSSH- së, si dhe u rrit numri total i punonjësve nga 65 në 73. Nga kjo strukturë konsiston që 5 prej tyre janë Anëtarët e Autoritetit, të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi me vendimet përkatëse; nr. 43, nr. 44, nr. 45, nr. 46, nr. 47, datë 09.06.2022.

Struktura dhe organika e Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, per vitin 2025 paraqitet si më poshtë:



Në fund të vitit 2025, numri i punonjësve efektivë në total është 71 ose 97.3 % e strukturës së miratuar, nga të cilët:

1. Anëtarë të Autoritetit 5 (pesë)
2. Nëpunës Civilë 60 (pesëdhjetë e nëntë)
3. Punonjës me “Kod Pune” pjesë e strukturës, 6 (gjashtë)
4. Vende vakante, nëpunës civilë 2 (dy)

- ***Punësimi i punonjësve sipas organigramës***

Siç është theksuar më sipër, në fund të vitit 2025 rezultojnë 2 vende vakante me fond page për rekrutim punonjës në nivelin ekzekutiv respektivisht në Drejtorinë e Verifikimit të Figurave dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, Digjitalizimit dhe Sigurisë.

Gjatë vitit 2025, janë kryer në total 7 shpallje për procedura rekrutimi. Kanë shprehur interes në këto procedura 13 kandidatë, nga të cilët janë kualifikuar për të hyrë në testim 8 kandidatë. Pas kryerjes së procedurave të përzgjedhjes sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për rekrutimet, janë shpallur fitues 7 kandidatë.

- ***Punësimi i punonjësve me kontratë të përkohshme***

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 09.1.2025 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025,

në Njësitë e Qeverisjes Qendrore AIDSSH ju dha e drejta të punësonte 14 punonjës me kontratë të përkohshme përkatësisht në pozicionet:

- 4 (katër) punonjës me emërtim “Operatorë”;
- 4 (katër) punonjës me emërtimin “Arkivist”;
- 4 (katër) punonjës me emërtimin “Nëpunës Informacioni”;
- 1 (një) punonjës me emërtimin “Bibliotekar”;
- 1 (një) punonjës me emërtim “Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme”

Pozicionet e mësipërme, u plotësuan me punonjësit që ishin përzgjedhur dhe kontraktuar gjatë vitit 2024 dhe që kishin një vlerësim pozitiv në punë nga ana e eprorëve të tyre si dhe me punonjës të rinj.

- ***Puna vullnetare pranë Autoritetit***

Gjatë vitit 2025, në kuadër të **marrëveshjes ndërmjet AIDSSH dhe Universitetit të Tiranës, 5 studentë kryen** praktikën mësimore prej 21 ditësh pranë AIDSSH.

Gjatë vitit 2025, në kuadër të Thirrjes së X-të, të “Programit Kombëtar të Praktikave të Punës”, të inicuar, drejtuar dhe udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, 1 studente kreu praktikën e punës pranë AIDSSH

- ***Trajnimet e punonjësve***

Gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me ASPA dhe institucione të tjera, janë kryer on-line një pjesë e konsiderueshme e trajnimeve, ku përfshihen dhe

trajnimet e 6 punonjësve në kuadër të pranimit në shërbimin civil me temë “Prezantimi me administratën publike”.

Temat në këto trajnime janë përzgjedhur nga punonjësit për përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe ngritjes profesionale, në funksion të realizimit të detyrave sipas pozicioneve të punës apo dhe të detyrave të reja të ngarkuara. Gjithsej 120 punonjës kanë marrë pjesë në 40 tema trajnimi të organizuar nga ASPA apo institucione të tjera për vitin 2025.

Kontrollet nga institucionet kompetente gjatë vitit 2025

- Parandalimi, Kontrolli dhe Zgjidhjen e Gjendjeve të Konfliktit të Interesit në AIDSSH.

Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin, Kontrollin dhe Zgjidhjen e Gjendjeve të

Konfliktit të Interesit në AIDSSH.

Janë kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësitë në pozicionin e anëtarit të Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin, Kontrollin dhe Zgjidhjen e Gjendjeve të Konfliktit të Interesit në Autoritet, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 9367, i ndryshuar, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, udhëzimeve përkatëse të IDKPI dhe rregullores së brendshme të Autoritetit, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

- *Njoftimi i subjekteve deklarues për plotësimin e deklarimit të interesave private “Periodik Vjetor”.*

Autoriteti Përgjegjës i ka kërkuar subjekteve deklaruese plotësimin e deklarimit të interesave private, kanë vijuar me njoftimin për deklarimin e interesave private “Periodik Vjetor”. Në fillim të vitit 2025 janë hapur uploaduar deklaratat periodike vjetore online të secilit prej subjekteve deklaruese sipas udhëzimit nr. 927, datë 1.11.2021.

Gjithashtu janë hapur llogaritë e reja të punonjësve që mbartin detyrim deklarimi të cilët janë rekrutuar me procedurat e rregullta të rekrutimit në shërbimin civil, siç ka qenë dhe pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Trajtimit të Kërkesave, të cilit ju spostua deklarimi nga Institucioni i Komisionerëve Publik tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Meqënëse znj. Shtino ka filluar marrëdhëniet e punës me Autoritetin në datën 1 Janar 2025, detyrimin për të deklaruar interesat personale (deklarim i interesave private për vitin 2024), e ka patur tek institucioni paraardhës ku edhe punonte.

(i) Subjekteve deklaruese të AIDSSH-së znj. Gentjana Sula dhe z. Altin Hoxha, z. Albert Nikolla, z. Gjergj Marku, z. Skënder Vrioni, z. Selami Zalli, znj. Sofi Noti, znj. Liliana Çoçoli, z. Anton Dukagjini, znj. Ornella Arapi, znj. Migena Demirxhiu, znj. Mimoza Zeneli, znj. Nertila Seitaj, dhe znj. Manjola Bici, është kërkuar plotësimi i formularëve të deklarimit të interesave private, sipas kërkesave të përcaktuara në Urdhrin nr. 996, datë 16.6.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e formularëve të deklarimit të

interesave private”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 16.6.2014, në të cilën janë miratuar ndryshimet në formularët e deklarimit si dhe plotësimi i deklaratave në format elektronik. Këta subjekte kanë plotësuar Deklaratën e Interesave Private Vjetore.

- (ii) Raste fillimesh të reja në detyrë apo largime të subjekteve deklaruese në Autoritet, për vitin 2025 nuk ka patur.
- (iii) Për çdo nëpunës civil, apo punonjës me kontratë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesave private që ditën e parë të fillimit të punës, (atat që kanë filluar punë në vitin 2025 pranë Autoritetit).
- (iv) Në regjistrin e konfliktit të interesave, rast për rast në formë libri, rezulton se për vitin 2025 nuk ka patur raste të konfliktit të interesave, rast pas rasti.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

Autoriteti Për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit.
Adresa: Njësia Administrative nr. 4, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë
www.aidssh.al